



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2020

**PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 24.09.2020)*

**Pika 1 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimit “Për fillimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimin) të gjyqtarëve që kanë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit”, i përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale.

*Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.*

*Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:08 dhe mbaroi në orën 13:20.*

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. *Naureda Llagami* (kryetare)
2. *Maksim Qoku* (zëvendëskryetar)
3. *Medi Bici* (anëtar)
4. *Fatmira Luli* (anëtare)
5. *Brunilda Kadi* (anëtare)
6. *Dritan Hallunaj* (anëtar)
7. *Ilir Toska* (anëtar)
8. *Alban Toro* (anëtar)
9. *Brikena Ukperaj* (anëtar)
10. *Marçela Shehu* (anëtare)

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 2. Helena Papa, Drejtore pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 3. Pjerin Prendi, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 4. Aeksandër Çavo, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 5. Luljeta Laze, Drejtore e Departamentit të Programimit dhe Administrimit të Buxhetit.*
- 6. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
- 7. Kelment Greca, Drejtor pranë Drejtorisë së Organizimit të Gjykatave dhe Standardeve.*
- 8. Pjesë nga stafi administrativ i Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 9. Entela Dobi, përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
- 10. Përfaqësues të Misionit EURALIUS dhe Projektit të "USAID".*

#### **RENDI I DITËS:**

1. Shqyrtimi i projektvendimit "Për fillimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimin) të gjyqtarëve që kanë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit", i përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale.

*Naureda Llagami:* Përsëritje të gjithëve!

Duke qenë se të gjithë anëtarët janë të pranishëm, po fillojmë mbledhjen e radhës të Këshillit të Lartë Gjyqësor, të datës 24 shtator 2020.

Siç jeni në dijeni, sa i përket rendit të ditës, sot nga ana e Këshillit kërkohet vendimmarrje për 11 çështje, ku çështja e fundit, që të paktën ju kam vënë në dijeni ditën e djeshme, ka qenë edhe hedhja e shortit për caktimin e relatorit në procedurën e verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Lartë, për kandidatin z. {...}.

Atëherë, pa humbur kohë le të fillojmë për sa i përket çështjeve, duke filluar me çështjen e parë e cila ka të bëjë me fillimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimin) të gjyqtarëve që kanë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit.

Për më shumë detaje, fjalën ia jap zonjës Ukperaj, kryetares së Komisionit të Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale. Fjala për Brikenën!

***Brikena Ukperaj:*** Faleminderit, zonja Kryetare!

Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale, në kuadër të programit të vlerësimeve por referuar dhe prioriteteve që ka Këshilli, aktualisht është përfshirë në dy procedura vlerësimi, procedura e parë që i përket asaj të gradimit të gjyqtarëve të konfirmuar në detyrë me vendim të formës së prerë dhe procedura e dytë është ajo sa i përket vlerësimit të përshpejtuar të detyruar të vitit kalendarik 2019, për gjyqtarët e kualifikuar për ngritje në detyrë.

Në kuadër të procedurës së parë që lidhet me përcaktimin e nivelit, pra gradës së gjyqtarëve që kanë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit, vjen dhe ky projektvendim, i cili kërkon miratimin nga mbledhja plenare të fillimit të kësaj procedure për tre gjyqtarë tashmë të konfirmuar me vendim të formës së prerë, në vijim edhe të gjyqtarëve të tjerë për të cilët ka filluar procedura. Këta tre gjyqtarë janë z. {...}, z. {...} dhe znj. {...}.

Jeni në dijeni që ky proces gradimi është i ndërvarur nga dërgimi i dosjeve të rivlerësimit nga organet e rivlerësimit. Me dërgimin e tyre në mënyrë të menjëhershme, Komisioni ka vlerësuar që ta fillojë këtë procedurë duke ia paraqitur këtë projektvendim mbledhjes plenare, bazuar në detyrimet e parashikuara nga neni 171, pika 5 e Ligjit për Statusin dhe aktet nënligjore të miratuara nga Këshilli.

Projektvendimi është i konceptuar sikundër edhe projektvendimet e tjera, në tre pika. Pika e parë i referohet fillimit të procedurës së vlerësimit etik dhe profesional, me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarëve. Pika e dytë i referohet caktimit të relatorit dhe nëpunësit përgjegjës për vlerësimin, që sikundër tashmë e kemi bërë praktikë, por edhe për shkak të parashikimeve nënligjore, zgjidhen me short midis tre anëtarëve të këtij Komisioni, duke siguruar një barazi të shpërndarjes së punës midis tyre.

Në procedurën e shortit për përzgjedhjen e relatorit për secilin gjyqtar, Komisioni ka vlerësuar që të përfshihen të tre anëtarët, për shkak dhe të asaj çka relatova më lart, ndërsa lidhur me numrin e nëpunësve përgjegjës për vlerësimin, që do të angazhohen në këtë proces, propozohet të përfshihen të njëjtët nëpunës, pra zonja Habili, zonja Hoxha dhe zoti Çoniku.

Nëse anëtarët nuk kanë ndonjë pyetje ose koment apo sugjerim lidhur me projekt-aktin, unë do të sugjeroja që të vazhdonim me procedurën e shortit. Faleminderit!

**Naureda Llagami:** Faleminderit, zonja Ukperaj!

Atëherë, nëse nuk kemi kundërshtime apo sugjerime, kalojmë në procedurën e hedhjes së shortit, e cila na mundësohet nga stafi administrativ.

Siç kemi vepruar gjithmonë, në një nga enët e qelqit do jenë emrat e relatorëve dhe në enën tjetër do jenë emrat e nëpunësve përgjegjës, ndërsa në enën tjetër do jenë emrat e gjyqtarëve, të cilëve do u bëhet vlerësimi.

Futen me radhë në enën e qelqit shiritat e letrës me emrat e 3 gjyqtarëve:

1. Z. {...};
2. Z. {...};
3. Znj. {...};

Futen me radhë në enën tjetër të qelqit shiritat e letrës me emrat e anëtarëve të Komisionit:

1. Znj. Brikena Ukperaj;
2. Znj. Brunilda Kadi;
3. Z. Erjon Muharremaj.

Futen me radhë në enën e tretë të qelqit shiritat e letrës me emrat e nëpunësve përgjegjës për vlerësimin:

1. Znj. Esmerilda Habili;
2. Z. Fatbardh Çoniku;
3. Znj. Gilda Hoxha.

Pas hedhjes së shortit rezulton si më poshtë:

1. Për gjyqtarin z. {...} - Relatore znj. Brunilda Kadi - Nëpunës përgjegjës për vlerësimin znj. Esmerilda Habili.

2. Për gjyqtaren znj. {...} - Relator z. Erjon Muharremaj - Nëpunës përgjegjës për vlerësimin znj. Gilda Hoxha.

3. Për gjyqtarin z. {...} - Relatore znj. Brikena Ukperaj - Nëpunës përgjegjës për vlerësimin z. Fatbardh Çoniku.

**Naureda Llagami:** Atëherë, kalojmë në miratimin e projekt-aktit pas edhe hedhje së shortit.

**Maksim Qoku:** Dakord.

**Brunilda Kadi:** Dakord.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Illir Toska:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Dakord.

**Marçela Shehu:** Dakord.

**Erjon Muharremaj:** Pro.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Medi Bici:** Pro.

**Naureda Llagami:** Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi: Fillimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimin) të gjyqtarëve që kanë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit kalimtar, për të cilët janë dorëzuar nga organet e rivlerësimit dosjet me aktet e vlerësimit profesional.

Caktimin e relatorit dhe nëpunësit përgjegjës për vlerësimin për secilin gjyqtar, si më poshtë:

1. Për gjyqtarin z. {...} - Relatore znj. Brunilda Kadi - Nëpunës përgjegjës për vlerësimin znj. Esmerilda Habili.

2. Për gjyqtarin z. {...} - Relatore znj. Brikena Ukperaj - Nëpunës përgjegjës për vlerësimin z. Fatbardh Çoniku.

3. Për gjyqtaren znj. {...} - Relator z. Erjon Muharremaj - Nëpunës përgjegjës për vlerësimin znj. Gilda Hoxha.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë me botimin në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

\* \* \*

(Pika e 1 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2020

**PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 24.09.2020)*

**Pika 2 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimit “Për fillimin e procedurës së përsheptuar të detyruar të vlerësimit etik dhe profesional viti kalendarik 2019, për gjyqtarët që kanë plotësuar kriteret ligjore të kandidimit për ngritje në detyrë”, i përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale.

*Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.*

*Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:08 dhe mbaroi në orën 13:20.*

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. *Naureda Llagami* (kryetare)
2. *Maksim Qoku* (zëvendëskryetar)
3. *Medi Bici* (anëtar)
4. *Fatmira Luli* (anëtare)
5. *Brunilda Kadi* (anëtare)
6. *Dritan Hallunaj* (anëtar)
7. *Ilir Toska* (anëtar)
8. *Brikena Ukperaj* (anëtar)
9. *Marçela Shehu* (anëtare)
10. *Erjon Muharremaj* (anëtar)

*Shënim:* Nuk merr pjesë në shqyrtimin e kësaj çështjeje anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. *Alban Toro*.

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 2. Helena Papa, Drejtore pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 3. Pjerin Prendi, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 4. Aeksandër Çavo, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 5. Luljeta Laze, Drejtore e Departamentit të Programimit dhe Administrimit të Buxhetit.*
- 6. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
- 7. Kelment Greca, Drejtor pranë Drejtorisë së Organizimit të Gjykatave dhe Standardeve.*
- 8. Pjesë nga stafi administrativ i Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 9. Entela Dobi, përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
- 10. Përfaqësues të Misionit EURALIUS dhe Projektit të "USAID".*

#### **RENDI I DITËS:**

2. Shqyrtimi i projektvendimit "Për fillimin e procedurës së përsheptuar të detyruar të vlerësimit etik dhe profesional viti kalendarik 2019, për gjyqtarët që kanë plotësuar kriteret ligjore të kandidimit për ngritje në detyrë", i përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale.

*Naureda Llagami:* Kalojmë në projekt-aktin e radhës, i cili edhe ky projekt-akt ka të bëjë me fillimin e procedurës së përsheptuar të detyruar të vlerësimit etik dhe profesional viti kalendarik 2019, për gjyqtarët që kanë plotësuar kriteret ligjore të kandidimit për ngritje në detyrë. Edhe ky projekt-akt është përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale.

Për më shumë detaje ia jap sërish fjalën zonjës Ukperaj.

*Alban Toro:* A mundet të bëj një ndërhyrje të lutem?



Në kushtet kur unë për një pjesë të kandidatëve që janë përshkruar në projektvendim nga numri 1 deri tek numri 6, kam dhënë dorëheqjen për çdo komponent të procedurës së ngritjes në detyrë. I bie që të dalë nga diskutimi dhe votimi, në kuadër të respektimit të dorëheqjes. Kështu që më thërrisni kur të vijë pika tjetër.

*(Zoti Toro del nga platforma dhe nuk merr pjesë në këtë pikë të rendit të ditës.)*

**Brikena Ukperaj:** Këshilli i Lartë Gjyqësor me vendimet nr.82, 83, 84, 85, 86, 87 datë 26.02.2020 dhe nr. 241, 242, 243, 244, 245, datë 09.07.2020, ka vendosur hapjen e procedurave të ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, nga radhët e gjyqtarëve, për 4 pozicione të lira në fushën e së administrative, 3 pozicione në fushën e të drejtës civile dhe 4 pozicione në fushën e të drejtës penale.

Pas mbarimit të afatit të aplikimit për të gjitha pozicionet e shpallura të lira në Gjykatën e Lartë, është zhvilluar procedura e verifikimit për plotësimin nga kandidatët aplikues të tre kriterëve të kandidimit sipas përcaktimeve të Vendimit nr.75, datë 23.05.2019, “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë”. Në përfundim të procedurës së verifikimit të tre kriterëve të kandidimit, përkatësisht “përvojës profesionale minimale”, “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”, për disa nga kandidatët, Këshilli ka vendosur vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit në procedurat e ngritjes në detyrë me vendimet e marra në mbledhjen e datës 17.09.2020.

Lidhur me procedurën e vlerësimit etik dhe profesional të kandidatëve për ngritje në detyrë, në secilin prej vendimeve të shpalljes se pozicioneve të lira për ngritje në detyrë parashikohet se: “Për kandidatin, për të cilin me vendim të Këshillit të Lartë Gjyqësor verifikohet plotësimi i kriterëve ligjore të kandidimit sipas shkronjave përkatëse<sup>4</sup>, fillon procesi i vlerësimit etik dhe profesional, referuar vendimeve 263 dhe 264 të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Sa më sipër, bazuar në Skemën e Vlerësimit të Gjyqtarëve dhe në Programin e Vlerësimeve të miratuar për vitin 2020, Këshilli duhet të fillojë me përparësi procedurën

e vlerësimit të përshpejtuar të detyruar etik dhe profesional, për kandidatët e verifikuar, të cilët kanë ushtruar funksionin e gjyqtarit në periudhën e vlerësimit që përfshin vitin kalendarik 2019.

Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale, në zbatim të neneve 85 dhe 97 të Ligji për Statusin, nenit 25 të Ligjit nr. 48/2019 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 96/2016” dhe Vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 263, datë 21.11.2019, pas përfundimit të procedurës së verifikimit për plotësimin e tre kritereve ligjore të kandidimit, për 9 nga gjyqtarët që kanë aplikuar për ngritje në detyrë në Gjykatën e Lartë, i propozon Mbledhjes Plenare, fillimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional me procedurë të përshpejtuar të detyruar për periudhën e vlerësimit viti 2019.

Referuar edhe vendimeve të marra, lista e gjyqtarëve përbëhet nga: znj. {...}, e cila kandidon për pozicionet e e lira në fushën e të drejtës administrative të shpallur me vendimet 84 dhe 245 të Këshillit të Lartë Gjyqësor; z. {...}; znj. {...}; znj. {...}; znj. {...}; znj. {...}; znj. {...}; z. {...}; z. {...}.

Vendimet janë të specifikuara në relacion, bashkë me pozicionet për të cilat ato janë kualifikuar.

Për sa më lart, mbështetur në nenin 147/a, pika 1, shkronja “a” dhe “ë” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 85 e vijues të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, nenin 61, pika 1, nenin 63 dhe nenin 86, shkronja “dh”, të Ligjit nr. 5/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, dhe vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor është përgatitur projektvendimi për fillimin e procedurës së përshpejtuar të detyruar të vlerësimit etik dhe profesional për 9 nga gjyqtarët.

Në pikën I të projektvendimit përcaktohet fillimi i procedurës për këta gjyqtarë.

Në pikën II të projektvendimit përcaktohet caktimi i relatorit dhe nëpunësit përgjegjës për vlerësimin, proces i cili realizohet nëpërmjet shortit midis anëtarëve të këtij Komisioni dhe ndërmjet tre nëpunësve të Njësisë së Vlerësimit Etik dhe Profesional, duke siguruar një shpërndarje të barabartë të punës midis nëpunësve dhe relatorëve.

Lidhur me procedurat e shortit, tashmë kemi një praktikë, në një vazo hidhen tre herë emrat e nëpunësve dhe tre herë emrat relatorëve, duke qenë se kemi 9 kandidatë, për të pasur një përzgjedhje rastësore, transparente të secili prej tyre.

Faleminderit, zonja Kryetare!

Nëse nuk ka ndonjë koment ose sugjerim, unë do të ftoja të vazhdonin procedurat e shortit.

*Naureda Llagami:* Faleminderit, Brikena!

Atëherë, do i kërkoja stafit administrativ të mundësonte procesin e hedhjes së shortit.

Futen me radhë shiritat e letrës me emrat e kandidatëve: znj. {...}, z. {...}, znj. {...}, znj. {...}, znj. {...}; znj. {...}; znj. {...}; z. {...}; z. {...}.

Futen me radhë shiritat e letrës me emrat e anëtarëve relatorë: Brikena Ukperaj (3 shirita me emrin e saj futen në enën e qelqit), Brunilda Kadi (3 shirita me emrin e saj futen në enën e qelqit), Erjon Muharremaj (3 shirita me emrin e tij futen në enën e qelqit).

Futen me radhë shiritat e letrës me emrat e nëpunësve përgjegjës për vlerësimin: Esmerilda Habili (3 shirita me emrin e saj futen në enën e qelqit), Fatbardh Çoniku (3 shirita me emrin e tij futen në enën e qelqit), Gilda Hoxha (3 shirita me emrin e saj futen në enën e qelqit).

Sipas shortit rezulton:

1. Për gjyqtarin z.{...} - Relator z. Erjon Muharremaj - Nëpunës përgjegjës për vlerësimin z. Fatbardh Çoniku.
2. Për gjyqtaren znj.{...} - Relatore znj. Brikena Ukperaj - Nëpunës përgjegjës për vlerësimin znj. Gilda Hoxha.
3. Për gjyqtaren znj.{...} - Relatore znj. Brikena Ukperaj - Nëpunës përgjegjës për vlerësimin znj. Gilda Hoxha.

4. Për gjyqtarin z.{...} - Relator z. Erjon Muharremaj - Nëpunës përgjegjës për vlerësimin z. Fatbardh Çoniku.
5. Për gjyqtaren znj.{...} - Relatore znj. Brunilda Kadi - Nëpunës përgjegjës për vlerësimin znj. Esmerilda Habili.
6. Për gjyqtaren znj.{...} - Relator z. Erjon Muharremaj - Nëpunës përgjegjës për vlerësimin znj. Esmerilda Habili.
7. Për gjyqtaren znj.{...} - Relatore znj. Brunilda Kadi - Nëpunës përgjegjës për vlerësimin z. Fatbardh Çoniku.
8. Për gjyqtaren znj.{...} – Relatore znj. Brikena Ukperaj - Nëpunës përgjegjës për vlerësimin znj. Gilda Hoxha.
9. Për gjyqtarin z.{...} - Relatore znj. Brunilda Kadi - Nëpunës përgjegjës për vlerësimin znj. Esmerilda Habili.

**Naureda Llagami:** Nëse nuk kemi diskutim, kalojmë në miratimin e projekt-aktit, bashkë me shortin e hedhur.

**Maksim Qoku:** Dakord.

**Brunilda Kadi:** Dakord.

**Dritan Hallunaj:** Pro. Nga momenti i fillimit të kësaj procedure e kam ndjekur me laptop-in tim në zyrën time. Faleminderit!

**Ilir Toska:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Dakord.

**Marçela Shehu:** Dakord.

**Erjon Muharremaj:** Pro.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Medi Bici:** Pro.

**Naureda Llagami:** Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi: Fillimin e procedurës së përsheptuar të detyruar të vlerësimit etik dhe profesional viti kalendarik 2019, për gjyqtarët që kanë plotësuar kriteret ligjore të kandidimit për ngritje në detyrë në Gjykatën e Lartë.

Caktimin e relatorit dhe nëpunësit përgjegjës për vlerësimin për secilin gjyqtar, si më poshtë:

1.Për gjyqtaren znj.{...} - Relatore znj. Brikena Ukperaj - Nëpunës përgjegjës për vlerësimin znj. Gilda Hoxha.

2.Për gjyqtarin z.{...} - Relator z. Erjon Muharremaj - Nëpunës përgjegjës për vlerësimin z. Fatbardh Çoniku.

3.Për gjyqtaren znj.{...} - Relatore znj. Brikena Ukperaj - Nëpunës përgjegjës për vlerësimin znj. Gilda Hoxha.

4.Për gjyqtaren znj.{...} - Relatore znj. Brunilda Kadi - Nëpunës përgjegjës për vlerësimin znj. Esmerilda Habili.

5.Për gjyqtaren znj.{...} - Relator z. Erjon Muharremaj - Nëpunës përgjegjës për vlerësimin znj. Esmerilda Habili.

6.Për gjyqtaren znj.{...} - Relatore znj. Brikena Ukperaj - Nëpunës përgjegjës për vlerësimin znj. Gilda Hoxha.

7.Për gjyqtaren znj.{...} - Relatore znj. Brunilda Kadi - Nëpunës përgjegjës për vlerësimin z. Fatbardh Çoniku.

8.Për gjyqtarin z.{...} - Relator z. Erjon Muharremaj - Nëpunës përgjegjës për vlerësimin z. Fatbardh Çoniku.

9.Për gjyqtarin z.{...} - Relatore znj. Brunilda Kadi - Nëpunës përgjegjës për vlerësimin znj. Esmerilda Habili.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë me botimin në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

\* \* \*

(Pika e 2 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2020

**PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 24.09.2020)*

**Pika 3 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimit “Për përcaktimin e kritereve dhe procedurave për dhënien e statusit të nëpunësit civil gjyqësor, punonjësve në detyrë në gjykata”, i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit (relatore Fatmira Luli).

*Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.*

*Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:08 dhe mbaroi në orën 13:20.*

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. *Naureda Llagami* (kryetare)
2. *Maksim Qoku* (zëvendëskryetar)
3. *Medi Bici* (anëtar)
4. *Fatmira Luli* (anëtare)
5. *Brunilda Kadi* (anëtare)
6. *Dritan Hallunaj* (anëtar)
7. *Ilir Toska* (anëtar)
8. *Alban Toro* (anëtar)
9. *Brikena Ukperaj* (anëtar)
10. *Marçela Shehu* (anëtare)

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 2. Helena Papa, Drejtore pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 3. Pjerin Prendi, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 4. Aeksandër Çavo, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 5. Luljeta Laze, Drejtore e Departamentit të Programimit dhe Administrimit të Buxhetit.*
- 6. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
- 7. Kelment Greca, Drejtor pranë Drejtorisë së Organizimit të Gjykatave dhe Standardeve.*
- 8. Pjesë nga stafi administrativ i Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 9. Entela Dobi, përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
- 10. Përfaqësues të Misionit EURALIUS dhe Projektit të "USAID".*

#### **RENDI I DITËS:**

3. Shqyrtimi i projektvendimit "Për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave për dhënien e statusit të nëpunësit civil gjyqësor, punonjësve në detyrë në gjykata", i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit (relatore Fatmira Luli).

*Naureda Llagami:* Kalojmë në çështjen e radhës të rendit të ditës, e cila ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit "Për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave për dhënien e statusit të nëpunësit civil gjyqësor, punonjësve në detyrë në gjykata".

Siç jeni në dijeni, ky projekt-akt është përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit dhe është pjesë e rendit të ditës që në mbledhjen e kaluar të datës 17.09. dhe u shty për shqyrtim për shkak të kërkesës së zotit Toska për të marrë informacion mbi numrin e punonjëse në detyrë në gjykata, të cilat nuk i plotësojnë kriteret ligjore.

Nga ana e administratës, ky informacion iu është vënë në dispozicion secilit prej anëtarëve të Këshillit, kështu që besoj jemi të gatshëm për të marrë në shqyrtim dhe miratuar projekt-aktin në fjalë.

Për më shumë detaje unë do doja që t'ia jepja fjalën relatores së projekt-aktit, znj. Fatmira Luli.

**Naureda Llagami:** Konfirmoj që Albani ka hyrë.

**Fatmira Luli:** Faleminderit, Kryetare!

Shkurtimisht parashtroj se ky ndryshim në ligj dhe përcaktimi i statusit të nëpunësit civil gjyqësor u bë mbas miratimit të ligjit nr.98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, sipas nenit 1/d të këtij ligji objekt i këtij ligji është përcaktimi i parimeve të përgjithshme dhe i rregullave ndër të cilat edhe në lidhje me statusin e nëpunësit civil gjyqësor, përcaktim ky i ri i ndryshëm nga ai i mëparshëm i ligjit “Për organizimin e pushtetit gjyqësor”.

Ligji i ri ka përcaktuar administratë gjyqësore si struktura dhe tërësia e veprimtarive që do të synojnë organizimin dhe sigurimin e funksionimit të gjykatave. Ndërsa nga ana tjetër, ligji ka vendosur krijimin e Shërbimit Civil Gjyqësor, të përbërë nga trupa e nëpunësve civilë gjyqësorë, që do të ushtrojnë funksione administrative publike brenda shërbimit gjyqësor ose administrativ të një gjykate, në mbështetje të drejtpërdrejtë të sistemit gjyqësor.

Administrata gjyqësore realizon misionin e saj nëpërmjet shërbime gjyqësore, shërbime administrative dhe shërbime mbështetëse. Neni 50 i këtij ligji ka përcaktuar kategoritë e nëpunësve civilë gjyqësorë që e përfitojnë këtë status nëpunësi civil gjyqësor dhe ka sanksionuar statusin e tyre i cili përcaktohet kryesisht nga ky ligj.

Në vijim, ligji parashikon rregulla të detajuara në lidhje me formimin profesional, vlerësimin kualifikues, kriteret e përgjithshme dhe të veçanta për të cilat e të administrata duhet të pranohet si nëpunës civil gjyqësor, lëvizjen, ngritjen në detyrë, emërimin, të drejtat dhe detyrat e nëpunësit civil gjyqësor, vlerësimin e veprimtarisë së tyre,



transferimin, pezullimin nga shërbimi civil gjyqësor, përgjegjësinë disiplinore, ndërprerjen e marrëdhënies së punës si dhe regjistrin qendror të personelit.

Për të siguruar zbatimin e këtij ligji, ky ligj vet ka cituar dhe ka referuar nëpërmjet dispozitave të veçanta në ligjin e nëpunësit civil dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të këtij ligji nga organet kompetente, si dhe duke autorizuar Këshillin e Lartë Gjyqësor që të nxjerrë disa akte nënligjore, mes të cilave është edhe ky që po diskutojmë sot, pra akte të tjera që janë përgatitur nga Komisioni, të cilat rregullojnë aspekte të veçanta të fushës së veprimit dhe zbatimit të ligjit. Njëkohësisht ligji e ka autorizuar Këshillin e Ministrave të nxjerrë akte nënligjore normative, si për shembull ai për strukturën e pagave për të cilën do bëhet edhe klasifikimi i pozicioneve në shërbimin civil gjyqësor, si dhe duke parashikuar dispozita tranzitore, të cilat kanë si qëllim rregullimin e situatës faktike para hyrjes në fuqi të këtij ligji apo deri në zbatimin e tij, që kanë lidhje me vendosjen e marrëdhënieve të punës në shërbimin civil gjyqësor të punonjësve në detyrë, marrëdhënia e punës e të cilëve ka filluar para hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Referimi në ligjin “Për nëpunësin civil gjyqësor” -

Shërbimi civil u rregullua për herë të parë në vitin 1996 me ligjin nr.8095 dhe ky ligj nuk arriti të gjente zbatim dhe pas tre vitesh nga miratimi i tij, u zëvendësua me një ligj tjetër të nëpunësit civil gjyqësor dhe deri më sot ky ligj ka pësuar disa ndryshime në vite, ndryshime këto që kanë rregulluar anë të veçanta të tij lidhur me nëpunësin civil në tërësi në administratën publike.

Dispozitat ligjore të cilat rregullojnë marrëdhënien e nëpunësit civil gjyqësor, kanë referime të shumta në ligjin “Për nëpunësin civil”, për aspekte të cilat ligji nr.98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, nuk i ka të rregulluara në mënyrë të veçantë. Në pjesën më të madhe të referimeve bëhen qartësisht vetëm në ligjin “Për nëpunësin civil”, duke mos përfshirë aktet nënligjore që kanë dalë në bazë dhe për zbatim të tij.

Është vepruar në mënyrë të tillë nga ligjvënësi, në zbatim të parimit kushtetues të pavarësisë së pushtetit gjyqësor, duke synuar një rregullim të drejtpërdrejtë nga ky ligj i posaçëm i joni Për shërbimin civil gjyqësor, me akte nënligjore të Këshillit të Ministrave, të autorizuara për t’u nxjerrë sipas ligjit “Për nëpunësin civil”.

Në secilin nga këto raste, ligji “Për organizimin e pushtetit gjyqësor” i jep autorizimin, sipas dispozitave kushtetuese, organit qeverisës të pushtetit gjyqësor, Këshillit të Lartë Gjyqësor, për të nxjerrë akte nënligjore normative, të cilat do të bëjnë rregullim në mënyrë të detajuar të atyre aspekteve që tek ligji “Për nëpunësin civil”, janë rregulluar më akte të Këshillit të Ministrave por që ne tani na lind përgjegjësia t’i rregullojmë me akte të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Atje ku ligji “Për organizimin e pushtetit gjyqësor” urdhëron referimin edhe në aktet nënligjore të dala në zbatim të ligjit “Për nëpunësin civil”, e thotë këtë në mënyrë të shprehur dhe të qartë në dispozitat e saj.

Dispozitat tranzitore në lidhje me dhënien e statusit të nëpunësit civil gjyqësor, punonjësve në detyrë në gjykata –

Të tërë punonjësit, sipas përcaktimeve që ka bërë ky akt të cilët do përfitojnë statusin e nëpunësit, konsiderohen “punonjës në detyrë në gjykata”. Punonjësit e tjerë që kanë statusin e nëpunësit sipas termave të përcaktuar që në hyrje të këtij akti, konsiderohet “punonjës të tjerë në detyrë në gjykata”.

Ligji “Për organizimin e pushtetit gjyqësor” ka parashikuar se ushtrimi i funksioneve administrative publike brenda shërbimit gjyqësor ose administrative të një gjykate, në mbështetje të drejtpërdrejtë të sistemit gjyqësor, do të bëhet vetëm nga nëpunësit civil gjyqësorë.

Deri në momentin e miratimit dhe hyrjes në fuqi të këtij ligji, ky rregullim është bërë nga Kodi i Punës për të gjithë administratën gjyqësore.

Për të rregulluar këtë situatë faktike dhe ligjore, Ligji “Për organizimin e pushtetit gjyqësor” ka parashikuar, në nenet 83 – 88 të tij, një procedurë për vlerësimin e plotësimit të kriterëve formale të punonjësve apo “nëpunësve civilë në detyrë” për pozicionin që ata kryejnë, sipas këtij ligji, procedurë e cila përfundon me dhënien e statusit të nëpunësit civil gjyqësor, sistemimin në një pozicion tjetër brenda administratës gjyqësore ose përfundimin e marrëdhënieve të punës.

Në këto dispozita përcaktohen qartë edhe kriteret e përgjithshme të posaçme si dhe procedura për dhënien e statusit civil gjyqësor.

Organi kompetent për zhvillimin e kësaj procedure është Këshilli i Gjykatës, i cili duhet të zhvillojë këtë procedurë në përputhje me aktet nënligjore normative të nxjerra në zbatim të neneve 84, pika 6, 85, pika 6 dhe 86. Këto dispozita autorizojnë Këshillin e Lartë Gjyqësor, si organi kompetent për të nxjerrë akte nënligjore normative me objekt miratimin e rregullave të detajuara për kritere të tjera që lidhen me specifikat e pozicionit të nëpunësve civilë gjyqësor, si dhe për procedurat që ndiqen me qëllim zbatimin e unifikuar të standardeve në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Konteksti faktik në të cilën Këshilli i Lartë Gjyqësor duhet të miratojë këto akte dhe akte të tjera në zbatim të tij është sipas parashikimeve ligjore por afatet kohore janë të spostuara në vite për shkak të faktit që vetë Këshilli i Lartë Gjyqësor u ngrit pas 2 vjetësh të miratimit të këtij ligji dhe këshillat e gjykatave dhe këto akte dalin prapë në një kohë shumë të mëvonshme, mbas hyrjes në fuqi të ligjit “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”. Në këto kushte jemi me vonesë për nxjerrjen e të gjitha akteve ligjore, për t’i dhënë statusin nëpunësit civil gjyqësor të tërë punonjësve të administratës jashtë afateve që ka përcaktuar vet ligji në momentin që është miratuar.

Këshilli i Lartë Gjyqësor ka deklaruar krijimin e tij me datë 12.12.2018. Në datë 21.12.2018, me vendimin nr. 7, është miratuar rregullorja “Për miratimin e rregullave për zgjedhjen e zëvendëskryetareve të gjykatave”, ku janë përcaktuar rregulla për organizimin e pushtetit dhe në përmbushje të funksionit Këshilli i Lartë Gjyqësor drejton dhe kujdeset për mbarëvajtjen e punës në administratën gjyqësore. Në këtë aspekt, Këshilli ka ndërmarrë një sërë aktesh normative për nëpunësit civilë gjyqësorë, me qëllim krijimin e një shërbimi civil të qëndrueshëm e profesional. Referenca kryesore ligjore në hartimin e këtyre akteve normative ka qenë legjislacioni i shërbimit civil, duke synuar një përafrim maksimal dhe një standard më të lartë, në raport me statusin e nëpunësit civil, duke marrë për bazë ligjin nr.98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”.

Shkurtimisht, struktura dhe përmbajtja e këtij akti ligjor është sa vijon më poshtë.

Në nenin 1 të këtij projekt-akti që paraqesim për shqyrtim sot në seancën plenare, është përcaktuar objekti i cili është përcaktimi i rregullave në lidhje me procedurat që do të ndiqen nga Këshilli i Gjykatës për dhënien e statusit të nëpunësit civil gjyqësor, për

punonjësit në detyrë në gjykata. Synimi i vendosjes së këtyre rregullave është për t'i përcaktuar në mënyrë më të detajuar në ato që parashikon ligji, është zbatimi i unifikuar të standardeve nga ana e Këshillave të Gjykatave, gjatë këtyre procedurave, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Në nenin e dytë, janë përcaktuar subjektet e këtij projektvendimi. Sipas parashikimeve që bën neni 50 i ligjit 98/2016, duke i kategorizuar sipas përcaktimeve në shkronjat ç), d), dh), e), të pikës 1, të këtij neni.

Në nenin 3 janë vendosur përkufizime, me anë të të cilëve është synuar sqarimi dhe qartësimi i terminologjisë së përdorur në projektvendim në funksion të efektivitetit dhe interpretimit të drejtë të këtyre dispozitave.

Në nenin 4 janë vendosur kriteret formale, të cilat do të merren në vlerësim nga Këshilli i Gjykatës gjatë procedurës për dhënien e statusit. Këto kritere janë të përcaktuara qartësisht në nenet 55 dhe 56 të ligjit 98/2016. Edhe pse këto kritere janë vendosur në ligj, është menduar që ato të jenë pjesë e këtij projektvendimi me qëllim zbatimin sa më efektiv dhe më të qartë të tyre, për arsye se ky projektvendim do të shërbejë si bazë dhe do të unifikojë të tëra veprimet jo vetëm të Këshillave të Gjykatave, por edhe të punësuarve në gjykata dhe jo të gjithë kanë njohuritë e duhura për orientimin me ligjet. Kjo është arsyeja që ne kemi përfshirë edhe dispozitat e përgjithshme, kushtet e përgjithshme, për të qenë nëpunës i shërbimit civil gjyqësor nga ato që parashikon ligji "Për nëpunësin civil", për efekt përdorimi dhe zbatimi nga e gjithë administrata gjyqësore në të gjithë Republikën e Shqipërisë, në mënyrë të njëjtë për të tërë, pa pasur nevojë për të referuar dhe lexuar dispozitat e tjera ligjore. Neni 55 ka natyrë referuese tek ligji për nëpunësin civil, ndërsa neni 86 ka kritere shtesë të përcaktuar në ligjin e posaçëm. Ky projektvendim i mbledh të gjithë kriteret në një nen të vetëm. Afatet për kryerjen e procedurave janë të shkurtra dhe ky nen do të lehtësonte njohjen sa më të shpejtë me këto kritere me qëllim zbatimin e unifikuar të tyre.

**Naureda Llagami:** Kam përshtypjen që Fatmira doli nga linja.

**Fatmira Luli:** Duke patur në konsideratë këto dispozita, kriteret në pikën 1 të këtij neni janë të klasifikuara në kritere të përgjithshme dhe të veçanta. Kriteret e përgjithshme janë kriteret e vendosura për pranimin në shërbimin civil, të parashikuara në

ligjin nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, konkretisht në nenin 21 të ligjit. Ndërsa kriteret e veçanta janë ato të parashikuara në nenin 56 dhe në nenin 86, pika 2 të ligjit të posaçëm nr.98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”.

Po kështu, në nenin 5, duke qenë një procedurë mbi aktet, është menduar që shqyrtimi i çdo rasti të bëhet mbi bazën e një dosjeje personale, të krijuar për çdo punonjës, ku të jetë i depozituar i gjithë dokumentacioni provues i kriterëve formale sipas kësaj rregulloreje.

Në këtë kuadër, njësia e burimeve njerëzore ose punonjësi përgjegjës, i caktuar nga Kancelari, brenda 5 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij projektvendimi, do të njoftojnë punonjësit në detyrë, për dorëzimin dhe përditësimin e të gjithë dokumentacionit që vërteton plotësimin e kriterëve sipas nenit 4 të këtij projektvendimi.

Pas këtij momenti, punonjësi në detyrë do të plotësojë dosjen e tij personale me të dhënat që vërtetojnë kriteret sipas këtij vendimi, brenda 10 ditëve nga marrja e njoftimit sipas pikës 1 të këtij neni, së bashku me të dhënat mbi identitetin, adresën si dhe të dhënat elektronike të kontaktit, që përdoren për njoftim gjatë procedurës. Punonjësi në detyrë ka detyrë të informojë Kancelarin dhe personin përgjegjës për çdo ndryshim të mëvonshëm të adresës dhe të të dhënave të kontaktit elektronik. Shkelja e këtij detyrimi i bën të papranueshme të gjitha pretendimet për pavlefshmërinë e njoftimit dhe dokumentet do duhet të dorëzohen në origjinal ose të njësuara me origjinalin në përputhje me kriteret ligjore të vlefshmërisë së tyre.

Neni 6 - Në këtë nen parashikohet procedura për dhënien e statusit. Njësia e burimeve njerëzore ose punonjësi përgjegjës, nën mbikëqyrjen e Kancelarit, brenda 5 ditëve nga përfundimi i afatit për plotësimin e dosjes personale, i paraqet Këshillit të Gjykatës listën e plotë të punonjësve në detyrë, së bashku me dosjen përkatëse. Këshilli i Gjykatës, brenda një afatit 45 ditë nga marrja e dokumentacionit, bën verifikimin e plotësimit të kriterëve formale, për të gjithë punonjësit në detyrë sipas nenit 2 të këtij vendimi. Verifikimi i plotësimit të kriterëve formale bëhet nga Këshilli i Gjykatës sipas procedurës të parashikuar në nenin 28 të ligjit “Për pushtetin gjyqësor”.

Nëse punonjësi në detyrë nuk plotëson kriteret formale të pozicionit përkatës, Këshilli i Gjykatës i komunikon atij gjetjet dhe i shpjegon të drejtat për t’u dëgjuar, për të

paraqitur deklarata dhe prova të tjera, si dhe për t'u përfaqësuar, duke i caktuar dhe një afat, jo më shumë se 7 ditë, brenda të cilit duhet të përgjigjet me shkrim. Punonjësi në detyrë ka të drejtë të kërkojë dëgjimin e tij nga Këshilli i Gjykatës brenda 3 ditëve nga njoftimi i gjetjes. Këshilli i Gjykatës cakton një seancë dëgjimore nga marrja e këtij njoftimi ose të kërkesës që do bëjë punonjësi në detyrë për t'u dëgjuar nga Këshilli i Gjykatës.

Në përfundim të kësaj procedure Këshilli i Gjykatës vendos dhënien e statusit nëpunësit civil gjyqësor ose mosdhënien e tij. Kancelari i njofton vendimin, me shkrim, të arsyetuar të Këshillit të Gjykatës, të gjithë punonjësve të gjykatës brenda dy javëve nga data e vendimit të Këshillit të Gjykatës.

Pika 5 e këtij projektvendimi parashikon dhe elementët që duhet të përmbajë vendimi me qëllim unifikimin e tij për të gjithë Këshillat e Gjykatave, vendime këto janë analogji me akt vendimet e akteve administrative të dhëna sipas strukturës që duhet të ketë vendimi për të qenë të unifikuara, për t'u respektuar në mënyrë të njëjtë nga të gjitha gjykatat.

Në nenin 7 parashikohet sistemimi në një pozicion tjetër të punonjësit në detyrë, i cili nuk plotëson kriteret formale për pozicionin. Nëse punonjësi në detyrë nuk plotëson kriteret formale të pozicionit përkatës, Këshilli i Gjykatës vlerëson mundësitë ekzistuese për sistemimin në një pozicion tjetër brenda administratës së gjykatës, të përshtatshëm dhe në përputhje me kriteret ligjore dhe profesionale, nëse nuk ka arsye për përfundimin e marrëdhënieve të punës. Në këtë nen rregullohet edhe rasti i punonjësve në detyrë në gjykatë, të cilëve nuk i është dhënë statusi i nëpunësit civil gjyqësor si dhe ankimi në të cilin nuk është njohur. Në këtë rast ai konsiderohet si i punësuar në përputhje me kontratën e punës deri në sistemimin e tij në një pozicion tjetër sipas nenit 7.

Kontrata e punës së punonjësit në detyrë i cili nuk plotëson kriteret ligjore dhe profesionale sipas këtij vendimi për sistemimin në një pozicion tjetër, zgjidhet në përputhje me dispozitat e Kodit të Punës. Për këtë dispozitë është marrë edhe mendimi i EURALIUS-it i cili është përfshirë edhe në relacionin që sqaruar por edhe në draftin që i kemi paraqitur mbledhjes plenare për t'u miratuar.

Sistemi në një pozicion tjetër brenda administratës së gjykatës bëhet pas përfundim të të gjithë procedurave për dhënien e statusit. Këshilli i Gjykatës, për sistemimin e punonjësit në një pozicion tjetër mban parasysh dhe vjetërsinë e punës në sistemin gjyqësor. Në rastet kur punonjësi në detyrë në Gjykatat e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimet të Organizuar, nuk konfirmohet nga Këshilli përkatës i Gjykatës, bazuar në arsye të përcaktuara në pikën 2 të nenit 86 të ligjit Nr.98/2016, atëherë dosja e punonjësit në detyrë i përcillet Këshillit të Lartë Gjyqësor, në zbatim të parashikimeve të pikës 3 të nenit 86 të ligjit “Për Pushtetin Gjyqësor”.

Neni 9 parashikon regjistrimin e vendimeve të Këshillit të Gjykatës në Regjistrin Qendror të Personelit, i cili është një detyrim ligjor i parashikuar në nenin 88 të ligjit. Është e rëndësishme që të përmbushet detyrimi i Këshillit për mbledhjen e të dhënave dhe hedhjen e tyre pas sigurimit të aksesit nga ana e DAP-it, sipas nenit 63/3 të ligjit, sepse ky ligj, pavarësisht se përcakton ligjin “Për nëpunësin civil”, ligjin bazë mbi të cilën do rregullohet kjo veprimtari, përsëri në dispozita të caktuara referon edhe në ligjin “Për nëpunësin civil” dhe ka krijuar edhe detyrimin e njoftimit të këtij regjistri dhe këto të dhëna edhe DAP-it i cili administron të dhënat sipas ligjit.

Kancelari i paraqet Këshillit të Lartë Gjyqësor, brenda tri javëve, vendimet e Këshillit të Gjykatës në lidhje me statusin e punonjësve në detyrë, informacion nëse është paraqitur ankim brenda afatit kohor dhe informacion të nevojshëm për Regjistrin Qendror të Personelit. Në rastin kur është paraqitur ankim, Këshilli i Lartë Gjyqësor regjistron statusin e nëpunësit në detyrë në administratën gjyqësore, brenda një jave pasi është dhënë vendimi gjyqësor i formës së prerë i gjykatës.

Në nenin 10 parashikohet procedurat për dhënien e statusit për nëpunësit civil në detyrë në Gjykatën e Lartë. Konkretisht, rregullimet e mësipërme zbatohen edhe për këta nëpunës të cilët e kanë pasur më parë statusin e nëpunësit civil janë trajtuar si një organ i pavarur i cili ka përfituar dhe para hyrjes në fuqi të këtij ligji “Për statusin e nëpunësit civil”.

Në nenin 11 është përcaktuar që me hyrjen në fuqi të ligjit është parashikuar se pranimi në shërbimin civil gjyqësor i nëpunësve të tjerë civilë gjyqësorë, do të bëhej sipas rregullave të nenit 54 të ligjit, nëpërmjet një konkurrimi të hapur. Neni 60 i ligjit

parashikon se organi kompetent për emërimin e nëpunësve të tjerë civilë gjyqësorë është Këshilli i Gjykatës.

Në nenin 11 është menduar të vendoset një dispozitë tranzitore, e cila rregullon fuqinë juridike të mëtejshme të të gjitha kontratave të punës për punonjësit në detyrë, të lidhura pas vendimit nr. 166, datë 28.05.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor që ka pezulluar procedurën e lëvizjes paralele të ngritjes në detyrë dhe emërimin lidhur me punonjësit e gjykatave, statusi i të cilëve rregullohet nga ligji nr.98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”. Ato janë konsideruar absolutisht të pavlefshme, duke referuar për këtë në nenin 58 të ligjit, i cili përcakton se nëse një i punësuar në administratën në shërbimin gjyqësor punësohet në kundërshtim me dispozitat e ligjit të posaçëm atëherë ky punësim është absolutisht i pavlefshëm dhe në analogji me këtë është referuar në dispozitat tranzitore, që edhe të gjithë të punësuarit në kohën kur Këshilli i Lartë Gjyqësor kishte marrë vendimin për pezullimin, të konsiderohen absolutisht të pavlefshme.

Kjo ishte shkurtimisht përmbledhja e aktit që i paraqitet Këshillit për miratim, në mënyrë të detajuar të tëra kriteret, kushtet dhe procedurën, aktet që mbajnë me rastin në pranimin e shërbimit civil gjyqësor, të administratës dhe të punonjësve në gjykata. Faleminderit!

**Naureda Llagami:** Faleminderit zonja Luli për relatimin e projekt-aktit.

Fjalën e ka kërkuar zonja Kadi.

**Brunilda Kadi:** Faleminderit, Kryetare!

Unë me disa anëtarë të Këshillit që kemi bërë një diskutim në lidhje me rregulloren që sapo u relatua dhe është paraqitur për miratim, kemi disa sugjerime, kemi diskutim fillimisht në parim dhe pastaj propozimin konkret.

Së pari, lidhur me dispozitën tranzitore, si koncept mendojmë që nuk ka kuptim që të ketë dispozitë tranzitore në një rregullore që është vet tranzitore, pra është vetëm për një moment të caktuar, mbasi të mbarojë verifikimi dhe të ezaurohet objekti për të cilën po miratohet kjo rregullore, nuk do ketë më efekt, kështu që, për këtë arsye, qoftë edhe në



formë, nuk mendojmë se duhet të ketë dispozitë tranzitore, së pari. Së dyti, nga përmbajtja e vet nenit 11, që është propozuar si dispozitë tranzitore, mendoj që ka një problem sepse një akt në nivel rregulloreje që është akt nënligjor, nuk mund të përcaktojë se cili veprim është apo s'është absolutisht i pavlefshëm, atë e përcakton Kodi Civil dhe Kodi i Procedurës Administrative, nëse veprimi juridik është një akt administrativ, kështu që edhe në përmbajtje për ne ka problem. Ajo që ne sugjerojmë është që tek neni 2 ku përcaktohen subjektet, është thelbësore për këtë rregullore të përcaktohet se cilët do quhen punonjës në detyrë dhe kjo është logjikisht e lidhur me kohën që do përcaktojmë, që fikson këtë moment. Mendojmë që nuk mund të ketë kohë tjetër sepse ne nuk mund të ndryshojmë as ligjin dhe as arsyen pse është bërë ky parashikim i ri për nëpunësit në gjykatë dhe e lidhim këtë moment pa dyshim me momentin kur ka hyrë ligji në fuqi dhe tek pika 1 e nenit 2 ne sugjerojmë që mbas fjalisë së pikës 4, ku renditen kategoritë e punonjësve që do kenë këtë status, fjalia të vazhdojë: "...të cilët kanë qenë të punësuar në gjykata në datën e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 98/2016 "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë".

Ne propozojmë që në vazhdim të ketë edhe dy pika të tjera. Ky nen për të rregulluar situatën në gjykata, që do krijojë zbatimi i kësaj rregulloreje dhe në një farë mënyre dhe situata e këtyre punonjësve që janë punësuar pas hyrjes në fuqi të ligjit, dhe propozojmë konkretisht pikën 2 dhe 3 si më poshtë: "2. Punonjësit në gjykata të cilët janë punësuar pas hyrjes në fuqi të ligjit "Për pushtetin gjyqësor" do të vazhdojnë marrëdhënien e tyre të punësimit derisa ky propozim të plotësohet sipas procedurave për pranimin në shërbimin civil gjyqësor. Kjo pikë do sistemojë situatën që mund të krijohet nëpër gjykata nga vakanca e këtyre pozicioneve". Pika 3 propozohet të jetë e formuluar në këtë formë: "3. Punonjësit në gjykata, sipas pikës 2 të këtij neni, kanë të drejtë të konkurrojnë për pozicionin në të cilin janë të punësuar, sipas procedurave për pranimin në shërbimin civil gjyqësor. Nëse punonjësi nuk kualifikohet fitues për pozicionin, marrëdhënia e tij e punësimit zgjidhet sipas dispozitave të Kodit të Punës".

Këtë formulim, tani unë po e ndaj këtu tek platforma në formën e një fotografie që ta shikoni edhe më me kujdes të shkruar.

Nuk e di a shikohet.

Pra që të mos e ripërsëris. Ideja është që ne nuk mund të krijojmë pasoja juridike dhe të krijojmë situata të reja me rregulloren. Atë e përcakton ligji. Nuk cenojmë interesin e gjykatës sepse parashikojmë që këta do vazhdojnë marrëdhënien e tyre në atë pozicion derisa ky pozicion të plotësohet sipas ligjit sepse për ne është qartazi, punësimi i tyre, pavarësisht ka apo s'ka dikush faj në këtë situatë, është absolutisht i pavlefshëm, është bërë në kundërshtim me ligjin sepse është bërë nga organi që nuk përcakton ligji dhe nuk është respektuar procedura që përcakton ligji. Nga ana tjetër, këta punonjës, në momentin që kanë pranuar të futen në këtë lloj pozicionesh në kundërshtim me ligjin e kanë ditur këtë gjë, kështu që nuk është se u cenohet ndonjë e drejtë, kështu që mendojmë që e gjithë situata me këtë lloj formulimi është korrekte në përputhje me ligjin dhe nuk cenon askënd, as interesin publik të gjykatës për të pasur ecuri të punës por as interesin e këtyre të cilët kanë të drejtë si gjithë subjektet e tjera të konkurrojnë sipas ligjit. Por me këtë, së pari, nuk shkelim ligjin dhe së dyti, i japim mundësi atyre subjekteve të tjera që për shkak të mosrespektimit të procedurës nuk kanë pasur mundësi të konkurrojnë dhe që mbase mund të jenë edhe më të zotë sesa këta që janë aktualisht dhe mund ta meritojnë atë pozicion. Për të kujtuar që një nga thelbet e reformës në drejtësi ishte edhe kjo, rekrutimi i nëpunësve gjyqësorë sipas një procedure të caktuar dhe duke iu dhënë këtyre punonjësve një garanci të caktuar. Ata duhet ta meritojnë këtë status dhe të pranohen, pra të nisë procesi, fillimisht sipas ligjit dhe më tutje të vijojë.

Ky është propozimi im. Nuk e di anëtarët e tjerë nëse duan të shtojnë diçka. Faleminderit!

**Naureda Llagami:** Bruna të lutem, meqë propozimi prekte disa nene, nëse do na e mundësoje në ekran, do ishte më e lehtë për ne, për referimet që bëre dhe shtesat konkrete.

**Brunilda Kadi:** E kam ndarë, nuk e di a ka dalë?

**Naureda Llagami:** Jo! –nuk ka dalë.

Stafi administrativ ta mundësojë propozimin konkret që ka zonja Kadi.

**Fatmira Luli:** A të flas Kryetare, të japë dy sqarime?

**Naureda Llagami:** E ka kërkuar fjalën Erjoni pas Brunës dhe pas Erjonit, Brikena.

**Fatmira Luli:** Desha të sqarojë dy gjëra.

**Erjon Muharremaj:** Për zonjën Luli heq dorë nga kërkesa ime.

**Naureda Llagami:** Fjala për zonjën Luli.

**Fatmira Luli:** Kishim parashikuar në draftin e parë në nenin 2, pika e fundit, që të punësuar do të konsiderohen ato që kanë qenë në detyrë në gjykata dhe nuk përcaktuam kohën se kur për shkak të efekteve negative që mund të krijonte përcaktimi i këtij afati në pasojat që mund të krijonte për të larguar nga puna një numër shumë të madh sekretarësh gjyqësorë dhe punonjës të tjerë në gjykata, që nuk plotësonin kriteret. Kështu që kjo ishte arsyeja për të cilin ne nuk e vumë në nenin 2 kohën kur ky ligj do të konsideronte nëpunësit në detyrë në gjykata si nëpunës civilë gjyqësorë. Por këtë ta diskutojë dhe ta vendosë Këshilli se kur do jetë kjo kohë dhe kush do konsiderohen. Në fakt e konsideroj zgjidhjen si më të mundshme faktin që të gjithë këto punonjës që janë marrë në kundërshtim me ligjin dhe ta heqim shprehjen “e pavlefshme”, t’i konsiderojmë që janë me kontrata pune deri në momentin që mbaron procedura e dhënies së statusit dhe të ruajnë vendin e punës deri në zënien e këtyre, shpalljen e konkurrimit për zënien e vendeve të punës me persona që gëzojnë statusin e nëpunësit civil dhe ato të kenë të drejtën e konkurrimit që të mos humbin asnjë gjë, njësoj si të tjerët, me privilegjin që kanë edhe eksperiencën në këto institucione. Ndërsa ato sekretarë gjyqësorë ose nëpunës të tjerë që nuk plotësojnë kriteret do të qëndrojnë në detyrë derisa vendet e tyre të zihen në punë.

Kështu që jam dakord me propozimet e bëra për nenin 11, vetëm me ndryshimin që nëse punonjësi nuk kualifikohet fitues për pozicionin, marrëdhënia e tij nuk zgjidhet menjëherë, por shihet mundësia e sistemit në një vend tjetër pune dhe zgjidhet kur nuk ekziston asnjë mundësi për sistemin e tyre në vendet e punës. Kjo ndoshta do të krijojë një afat, se kjo do ketë një kohë, dhe mund të shkojë ndoshta edhe 1 vit e 2 vjet, për të gjithë ata nëpunës civilë sekretarë gjyqësorë, të cilët s’plotësojnë edhe kushtin formal të arsimimit. Do kenë një kohë më të gjatë ndoshta të gjejnë një punësim tjetër ose të

plotësojnë ndonjërin edhe me shkollim, ato mungesa që parashikon ligji dhe të ketë të drejtën, që në momentin që të shpallet konkursi për këto vende pune, të marrin pjesë. Kaq kisha. Faleminderit!

***Naureda Llagami:*** Zoti Muharremaj!

***Erjon Muharremaj:*** Faleminderit, zonja Kryetare!

Në fakt, unë kisha një propozim në lidhje me nenin 4, pika 3 e tij, ku bëhet fjalë për kriteret e veçanta, nënparagrafi /ç/, ku bëhet fjalë për pozicionin e nëpunësit të financës dhe të buxhetit. Nënparagrafi /i/ thotë: “i) të jetë i diplomuar në shkencë ekonomike, të paktën në nivelin "Master shkencor" ose të barasvlershëm me të...” si dhe pika d) për pozicionet drejtuese si nëpunës civil gjyqësor, në fusha të tjera të shërbimeve administrative të gjykatës, nënparagrafi /i/ thotë: “i) të jetë i diplomuar në drejtësi, ekonomi ose teknologji e informacionit ose shkencë komunikimi/gazetari, ose në fusha të tjera të përshtatshme me përshkrimin e punës, të paktën në nivelin "Master shkencor" ose të barasvlershëm me të, sipas përcaktimeve të legjislationit të arsimit të lartë”.

Pra kjo dispozitë referon tek legjislacioni “Për arsimin e lartë”, konkretisht që është ligji 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimit shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, ku neni 75 i tij, në pikën 3, përcakton që: “Programet e studimit “Master i shkencave” pajisin të diplomuarit me njohuri të thelluara teorike, si edhe me aftësim për kërkim shkencor në një fushë të caktuar”, dhe nënparagrafi /a/ thotë që: “a) programe që realizohen me jo më pak se 120 kredite...”. Në pikën 6 të nenit 75 të ligjit “Për arsimin e lartë” jepet shpjegimi për programet e studimeve “Master profesional” që pajisin të diplomuarit në njohuri të thelluara profesionale në një fushë të caktuar. Këto programe realizohen me 60 ose me 120 kredite. Për të dy këto pozicione në gjykata, aftësitë që kërkohen në fakt janë profesionale dhe jo teorike dhe masteri shkencor jep aftësi teorike, ndërsa profesionali jep aftësi profesionale.

Prandaj unë propozoj që, përveç “Masterit shkencor” ose të barasvlershëm me të, të shtohet edhe “Masteri profesional” që ka të njëjtin numër kreditesh me masterin shkencor, pra në 120 kredite. Pra pas ““Master shkencor” ose të barasvlershëm me të...”

të shtohet edhe “ose “Master profesional” me të njëjtin numër kreditesh”, - ky është propozimi im. Faleminderit!

**Naureda Llagami:** Faleminderit, zoti Muharremaj!

Në fakt, lidhur me propozimin tuaj, Fatmira kemi ndonjë koment?

**Fatmira Luli:** Në fakt mund të bëhet një lloj ndryshimi sepse ne diskutuam gjatë atëherë dhe morëm mendim edhe nga drejtoresha e buxhetit Luljeta Laze dhe referuar edhe në ligjin e posaçëm për financat, i cili parashikonte terma të ndryshëm “nëpunës zbatues” me “drejtues buxheti” dhe ramë dakord që “nëpunësi zbatues” sipas ligjit është drejtuesi i buxhetit, ai duhet të ketë “Master shkencor”. Ndërsa ai që është punonjësi i thjeshtë specialist nuk duhet të ketë “Master shkencor” por të ketë “Master profesional” dhe ndoshta këtu duhet të korrigojohet, siç e kemi bërë në draft, të themi me një ndryshim në pikën /c/ të nenit 4, pika 3/c, kemi thënë për nëpunësit zbatues “Master shkencor”, ndërsa për pikën /ç/ punojnë si specialistë të financës dhe të heqim “nëpunësin”, të vëmë “Master profesional”, të ndryshohet. Kështu që mund të shkojë ky sugjerim. I vetmi ndryshim që mund të bëjmë. Ligji thotë “nëpunës zbatues” dhe që në fakt është drejtuesi i financës dhe i buxhetit dhe atij t’i kërkojmë “Master shkencor” dhe atij që është specialist i thjeshtë të mos ketë nevojë për “Master shkencor” por të ketë “Master profesional”, pasi nuk është e nevojshme dhe është teprim për të kërkuar një master të këtij niveli. Kështu që mund ta bëjmë këtë ndryshim vetëm tek neni 4, pika 3/ç. Të heqim fjalën “Master shkencor” dhe të vëmë “Master profesional”. Ky ndryshim mund të bëhet. Për “nëpunësin zbatues” pastaj nuk bëhet dot ndryshimi nga “Master shkencor në profesional” sepse jo vetëm ky ligj por edhe ligji “Për menaxhimin financiar” e ka kusht “Masterin shkencor”, janë në unitet bashkërisht të dyja këto ligje.

**Naureda Llagami:** Faleminderit Fatmira për komentin!

Ia jap fjalën zonjës Ukperaj, e cila e ka kërkuar.

**Brikena Ukperaj:** Faleminderit, zonja Kryetare!

Në përgjithësi jam dakord me përmbajtjen e projekt-aktit të propozuar.

Kam disa sugjerime, komente. Po i marr me radhë.

Fillimisht duhet të reflektohet në preambulën e projektvendimit emri korrekt i Komisionit, që është shkruar “Komisionit të Planifikimit Strategjik dhe Administrimit të Buxhetit”, në fakt është “Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit”. Një korrigjim për të qenë korrekt me emrin e Komisionit, referuar ligjit.

Së dyti, lidhur me dispozitën tranzitore, për të cilën edhe zonja Kadi shprehu shqetësimin dhe propozoi që ajo nuk duhet të përfshihet në projekt-akt. Edhe unë ndaj të njëjtin qëndrim. Nuk mund të ketë një dispozitë tranzitore një projekt-akt që në fakt rregullon një dispozitë tranzitore dhe veç komenteve të bëra nga zonja Kadi, dua të shtoj edhe diçka, që karakteri i një dispozite kalimtare ose shtate tranzitore, dispozite tranzitore, është të rregullojë një situatë fakti që ekziston dhe për ta zgjidhur. Nga relacioni nuk shprehet dhe nuk na është bërë dijeni në fakt se sa është ky numri i punonjësve që janë rekrutuar pas vendimit të pezullimit.

Nga informacioni i përditësuar që na ka sjellë administrata e Këshillit, më rezulton që pas vendimit të pezullimit, nuk ka asnjë procedurë të tillë apo emërim, kështu që nuk ka sens që të rregullojmë diçka që në fakt nuk ekziston.

Duke u bashkuar edhe me komentet e tjera të zonjës Kadi, jam dakord që nuk ka kuptim të vendoset dispozita tranzitore, pra neni 11 duhet të hiqet, nuk duhet të qëndrojë.

Një propozim tjetër që kam lidhet me nenin 6, që ka të bëjë me elementët që duhet të ketë vendimi i gjykatës, ku në pikën 4, në pjesën e dispozitivit është parashikuar e drejta e ankimit në Gjykatën Administrative të Apelit. Për mua, pjesa “Gjykatën Administrative të Apelit” duhet të hiqet dhe duhet të shkruhet thjesht “e drejta e ankimit në gjykatë, brenda dy javëve nga njoftimi i vendimit”. Pse e them këtë gjë?

Në fakt, në të gjithë pjesën që rregullon ligji 98/2016, që rregullon statusin e nëpunësve civilë, Gjykata e Apelit Administrativ përfshihet vetëm në rastin kur nëpunësi gjyqësor civil ankimon vendimin e Këshillit. Pra që të shkosh në Gjykatën e Apelit Administrativ, duhet të legjistikohesh si nëpunës gjyqësor civil. Këta nuk janë nëpunës gjyqësorë civilë. Dispozita kalimtare e ligjit flet vetëm për gjykatë kompetente. Nëse do t'i referohemi edhe të drejtës së ankimit të kandidatëve që pretendojnë që të zënë një pozicion në shërbimin gjyqësor civil, ata nuk i drejtohen Gjykatës Administrative të

Apelit, por i drejtohen gjykatës kompetente. Në kushtet kur nuk mund të rregullojmë kompetencën e një gjykate me akt nënligjor dhe i përket juridiksionit gjyqësor ta vendosë, mendoj që duhet të ketë thjesht të drejtë ankimi në gjykatë brenda dy javëve nga ankimi i vendimit, sepse mund të ketë interpretime të ndryshme nëse është Gjykatë Apeli Administrativ apo është gjykata administrative e shkallës së parë, apo është edhe gjykatë e juridiksionit të përgjithshëm. Kjo është çështje që i përket juridiksionit gjyqësor për ta vendosur dhe jo aktit nënligjor.

Pra propozoj që pjesa “Gjykatën Administrative të Apelit” të hiqet, duke mbetur thjesht “të drejtën e ankimit në gjykatë”.

Këto ishin sugjerimet e mia lidhur me projekt-aktin.

Ndërsa dua të shpreh mendimin tim lidhur me propozimin e bërë nga zonja Kadi që na është shpërndarë edhe në ekranin e kompjuterit.

Në vlerësimin tim, përkufizimi që është bërë nga Komisioni, duke përfshirë punonjës në detyrë të gjithë të punësuarit para dhe pas hyrjes në fuqi të ligjit, është i drejtë sepse punësimi i punonjësve, pas hyrjes në fuqi të ligjit, në vlerësimin tim, nuk është i pavlefshëm, nuk është bërë punësim për statusin e nëpunësit gjyqësor civil, por është bërë punësim sipas Kodit të Punës.

Çfarë do të bënin kryetarët e gjykatave 2 vjet apo 3 vjet derisa të krijohej Këshilli i lartë Gjyqësor? – Do paralizojnë veprimtarinë gjyqësore sepse nuk kishin mundësi që të rekrutonin sipas nëpunësve gjyqësorë civilë? –Jo! Sigurisht që kanë ndërmarrë procedura në zbatim të Kodit të Punës. Sekretaret gjyqësore kanë 2 apo 3 vjet që punojnë dhe dua të them këtu që janë 57 punonjës të punësuar tashmë sipas Kodit të Punës. Nuk ka asnjë pengesë që Këshillat e Gjykatave, në momentin që verifikojnë të punësuarit para hyrjes në fuqi të ligjit, të verifikojnë edhe këta të punësuar pas hyrjes në fuqi të ligjit dhe nëse ata nuk plotësojnë kriteret, të procedohet njësoj sikur të ishin të punësuar para hyrjes në fuqi të ligjit.

Unë kam qenë edhe kundër vendimit të pezullimit. Në vlerësimin tim, procedurat nuk janë të pavlefshme sepse Këshillat nuk ishin krijuar. Këshilli i Gjykatës nuk ishte krijuar; dhe nga ana tjetër supozojmë sikur do zbatonim vendimin tonë, si mund të bëhej lëvizja paralele, kur asnjë s’kishte statusin e nëpunësit gjyqësor civil? Se, që të punësohet

sot ose në atë kohë një sekretar gjyqësor me status të nëpunësit gjyqësor civil, fillimisht vendi duhej t'i ofrohej dikujt që ka të drejtën e kthimit, pastaj duhet të shkojë në lëvizje paralele. Mund të bëhej lëvizja paralele? Çfarë do bënin gjykatat? Do mbeteshin pa personel?

Pra jam kategorikisht kundër shtimit që kërkon të bëjë zonja Kadi, duke nënkuptuar me “punonjës në detyrë”, pikërisht të gjithë të punësuarit si para ashtu edhe pas hyrjes në fuqi të ligjit. Të zhbllokojmë gjykatat, të fillojnë funksionalizimin. Mos harrojmë që referuar materialeve që janë vënë në dispozicion, janë rreth 63 punonjës nuk plotësojnë kushtet e arsimimit apo kushtet e tjera që lidhen me pozicionin. Për këta është parashikuar shumë mirë në projekt-akt që do shikohet mundësia e sistemimit dhe nëse mundësia e sistemimit nuk ekziston, pastaj vazhdojmë me zgjidhjen e kontratës së punës sepse nuk ka asnjë mundësi tjetër që të shpallet vendi vakant për rekrutime të reja sipas statusit të nëpunësit gjyqësor civil. Këto ishin sugjerimet e mia kundër propozimit të bërë nga zonja Kadi. Faleminderit!

**Naureda Llagami:** Faleminderit, zonja Ukperaj!

**Alban Toro:** Mund të flas të lutem?

**Naureda Llagami:** Po, zoti Toro!

**Alban Toro:** Ndoshta do të më duhet ta kundërshtoj pak Brikenën sepse nuk jam dakord me mendimin që aktualisht ato që kanë emëruar kryetarët në detyrë, personelin në gjykatë, të merren në konsideratë për t'u riintegruar, sikur nuk ka ndodhur asgjë. Fakti që nuk ka pasur Këshilla, nuk justifikon që ne të bëjmë veprime të tjera të paligjshme, kur dihet që respektimi i procedurës në nxjerrjen e një akti është një nga elementët më të rëndësishëm të ligjshmërisë së tij, dhe shkelja e procedurës ndikon direkt tek akti. Ndërkohë që gjithashtu shkelim disa parime, duke filluar nga neni 55, 56, 57, sidomos në mënyrë të veçantë neni 57, çdokush që ka punuar në një detyrë të caktuar në gjykatë, ka të drejtë të lëvizë në mënyrë paralele apo të ngrihet në detyrë dhe në kushtet kur kjo e drejtë i është mohuar sepse aktualisht mund të jetë zënë nga dikush tjetër, i marrë me kontratë pune, ai nuk ka mundësi ta respektojë apo t'i jepet kjo e drejtë. Kështu që në këtë drejtim, do të thoja që momenti i hyrjes në fuqi i ligjit i cili përcakton që subjektet që



kanë punuar në këtë moment do të konsiderohen si subjekte, që do të jetë e vlefshme kontrata e punës me ta, them që është një zgjidhje e drejtë dhe nuk mohon asnjë kategori, përfshirë edhe ata që kanë hyrë në mënyrë të paligjshme, sepse edhe për ta është menduar që t'u respektohet, pra t'u jepet mundësia që, mbasi të respektohen parimet e lëvizjes paralele dhe lëvizjes në detyrë dhe për ta të mendohet duke pasur parasysh edhe eksperiencën që ata kanë fituar tashmë dhe për ta të mendohet pranimi në shërbimin civil gjyqësor, kështu që besoj që propozimi i ezauron dhe ruan të drejtat e të gjithë palëve, duke mos cenuar askënd dhe duke mos shoqëruar një veprim juridik të pavlefshëm apo një paligjshmëri të bërë gjatë momentit të marrjes së njerëzve në marrëdhënie pune nga kryetarët në detyrë. Faleminderit!

**Naureda Llagami:** Atëherë, ka kërkuar fjalën sërish zonja Ukperaj dhe pas zonjës Ukperaj, ka kërkuar fjalën zoti Toska!

**Brikena Ukperaj:** Do doja të sqaroja edhe një herë që punësimi i tyre nuk është bërë në kuadër të asnjë akti administrativ absolutisht të pavlefshëm, por është bërë në bazë të Kodit të Punës, janë respektuar të gjithë procedurat që parashikon Kodi i Punës. Ata janë punonjës që janë marrë dhe vazhdojnë të kenë statusin, sikundër edhe të gjithë të punësuarit e tjerë me Kod Pune. Nuk mund të flasim për procedura të pavlefshme në kuadër të një rekrutimi me Kod Pune.

**Naureda Llagami:** Fjalën e ka zoti Toska!

**Fatmira Luli:** Atëherë, mund të them edhe unë dy.. t'i përgjigjem Brikenës lidhur me problemet që ngriti?

**Naureda Llagami:** Fatmira, kalojmë dhe tek zoti Toska dhe më pas e ke fjalën ti.

**Fatmira Luli:** Vetëm për të drejtën e ankimit desha të thoja dy gjëra.

E drejta e ankimit është e përcaktuar në nenin 64 të ligjit 98/2016, në pikën 2 tek dispozita për të drejtat dhe detyrat e nëpunësit civil gjyqësor, që bëhet fjalë për nëpunësit civilë që ne do t'i japim statusin, në pikën 2 të këtij neni thotë: “Nëpunësit civilë gjyqësorë kanë të drejtë të ankimojnë vendimet e Këshillit të Gjykatës në Gjykatën Administrative të Apelit.”, dhe këto janë të gjitha vendime që kanë të bëjnë me të drejtën

e tyre për t'u dhënë statusin, për masat disiplinore, për ngritjen në përgjegjësi. Kështu që këtë, na e ka vënë në mënyrë taksative ligji, nuk e kemi ne në dorë ta ndryshojmë. Prandaj mendoj që nuk duhet të hiqet ai parashikim, por duhet vënë sepse ky është i përcaktuar në ligj.

**Brikena Ukperaj:** Fatmira më fal, po dikujt që nuk i jepet statusi, ka të drejtë të shkojë në Gjykatën e Apelit Administrativ? Se okej, dikujt që i jepet statusi, s'ka sens që të shkojë në Gjykatën e Apelit Administrativ.

**Fatmira Luli:** Po, patjetër! - ai do ankimojë vendimin.

**Brikena Ukperaj:** Ja, ne të dyja kemi mendime të ndryshme se në cilën gjykatë duhet të shkojë. Prandaj po them, që ta lëmë "në gjykatë". Megjithatë, si ta vlerësojë Këshilli.

**Naureda Llagami:** Fjalën e ka zoti Toska!

**Illir Toska:** Faleminderit!

Atëherë, po filloj diskutimin me propozimin që bëri zonja Kadi, sa i përket vendosjes së disa shtesave në nenin 2.

Atëherë, unë mendoj në parim, që formulimi që është në tekstin e projektvendimit të mbetet siç është, pa u bërë ato shtesat. Kam në konsideratë për këtë, ndryshe nga sa zonja Kadi tha gjatë fjalës së saj, konstatoj se ligji ka konsideruar që do zbatohet idealisht menjëherë me hyrjen e tij në fuqi. Në fakt, ligji nuk ka marrë parasysh që momenti i zbatimit mund të shtyhet në kohë. Ka ndodhur për arsye objektive. Faktikisht jemi gati pas 4 vjetësh që do duhet të zbatohet ligji. Kjo distancë kohore, sipas meje, do duhet të kishte nxitur ligjvënësin që të mendonte se për periudhën deri në zbatim, të kishte disa dispozita që ta rregullonin situatën. Fakti ka ndodhur, që ligji po zbatohet tashmë pas 4 vjetësh. 4 vjet janë shumë për dikë që është punësuar dhe është punësuar me dispozitat e Kodit të Punës. Pra nuk është arritur dot, ka qenë e pamundur të zbatohet ligji i ri për sa i përket nëpunësit civil gjyqësor. Kjo, sipas meje, do të thotë që duhet ta zgjidhë Këshilli këtë diskordancën mes hyrjes në fuqi të ligjit dhe zbatimit të tij dhe opsioni që është paraqitur në projektvendim, për mendimin tim është korrekt. Ne do duhet që t'i konsiderojmë të gjitha punësimet që janë bërë derisa kemi vendosur pezullimin sepse

janë marrë sipas kriterëve të ligjit të ri, por pa mundur dot të bëjnë procedurat sepse që të bëhej procedura do duhej që të krijoheshin Këshillat e Gjykatave, përfshi edhe Këshillin e Lartë Gjyqësor, do duhej t'u jepej statusi, t'u konfirmohej statusi i nëpunësit civil gjyqësor dhe më tej të mund të procedohej me rekrutime rishtazi, gjë që s'mund të ndodhte. Kështu që janë bërë rekrutime për nevoja emergjente të gjykatave, pra për një interes të përligjur publik sepse parësore është funksionimi i institucionit. Kjo ishte sa i përket nenit 2.

Sa i përket propozimit që bëri zoti Muharremaj, unë jam dakord në parim me propozimin që bëri zoti Muharremaj, por me ndërhyrjet që bëri edhe zonja Luli. Mbase do të ishte vendi që të konsideronim propozimin e zotit Muharremaj tek pika /ç/, por edhe aty mund ta linim me alternativë ““Master shkencor” ose “profesional” ose të barasvlershëm me to”, dhe të zgjidhej situata.

Në lidhje me çështjen që ngriti zonja Ukperaj sa i përket gjykatës kompetente, mendoj që ne duhet ta lëmë në tekst siç thotë ligji “gjykatën kompetente”. Nuk mundemi ne, me një akt nënligjor të përcaktojmë gjykatën kompetente. Është vet sistemi i drejtësisë, gjykatat që do të shqyrtojnë rastet, ato që do të përcaktojnë kush është gjykata kompetente sipas ligjit, pra interpretimin e ligjit. Do të ishte e tepërt që ne të bënim një interpretim sepse në dune të fundit ai do të mbetej thjesht një qëndrim i yni dhe gjykata do duhet të respektonte, jo aktin tonë nënligjor, por ligjin. Kështu që, do të ishim më korrekt sikur të linim siç e ka formuluar ligjvënësi “gjykatë kompetente”, pa hyrë në debatin se kush është gjykatë kompetente në këtë moment, se më duket e tepërt të diskutoj se kush është gjykatë kompetente sipas meje. Faleminderit!

**Naureda Llagami:** Faleminderit, zoti Toska!

Fjalën ia jap zonjës Kadi!

**Brunilda Kadi:** Faleminderit, Kryetare!

Unë nuk dua të përsëris argumentet që dukshëm janë të ndryshëm nga ato që paraqiti zonja Ukperaj dhe zoti Toska në lidhje me pavlefshmërinë ose me termin “punonjës në detyrë”, thjesht dua të kundërshtoj argumentin që përmendën të dy në lidhje me faktin që ata janë punësuar sipas Kodit të Punës. Po! - është e vërtetë që janë punësuar

sipas Kodit të Punës, por ligji i cili nuk ka parashikuar këtë periudhën tranzitore dhe as këtë vonesën dhe ne nuk e gjujkojmë dot ligjin pse s'e ka bërë këtë gjë, se jemi për ta zbatuar, qartazi thotë që do ta bëjë shpunësimin në këtë mënyrë siç e kam përcaktuar unë (ligji), pra ky ligj, jo Kodi i Punës dhe asnjë lloj legjislacioni tjetër, i cili mund të jetë i nderuar dhe i respektuar, por që nuk është siç thotë ligji. Kështu që, për mua, qartazi ato janë absolutisht të pavlefshme si punësime dhe asnjë akt, sado dashamirës dhe interpretues e zgjerues që të jetë, vendimi ynë dhe aq më shumë një rregullore, nuk mund të shërojë cenet e një akti dhe i një veprimi juridik absolutisht të pavlefshëm. Thjesht dua ta ritheksoj që nuk cenohet fare puna e gjykatave sepse propozimi ynë e ka marrë parasysh këtë duke thënë që ata do vazhdojnë të rrinë dhe "de facto" do kenë prioritet/mundësi ta fitojnë atë vend pune sipas ligjit sepse tashmë ata kanë disa vite në atë pozicion dhe në mënyrë ndoshta jo të drejtë përkundrejt subjekteve të tjera që do kandidojnë ata e kanë këtë përvojë falë mundësisë që iu dha gjykata që i punësoi, -kjo për këtë argument.

Në lidhje me propozimin e zotit Muharremaj, jam shumë dakord me atë që e saktësoi zonja Luli dhe e riformuloi ndoshta më të plotë zoti Toska së fundmi (*shkëputet linja e zonjës Kadi*)...

Atëherë, më falni se u shkëputa.

Në lidhje me argumentin për gjykatën kompetente, diskutimin që bëri zonja Ukperaj dhe atë që e plotësoi zoti Toska, jam dakord, por mendoj që Komisioni, kur e ka draftuar, ka pasur një arsytim të pranueshëm kur ka bërë analogjinë me dispozitën që citoi zonja Luli, por gjithsesi unë jam me mendimin që kompetencën e gjykatës nuk mund ta përcaktojë Këshilli me një akt nënligjor, atë e përcakton vet sistemi. Kështu që, edhe sikur ta vëmë ne gjykatën, nuk e ka të detyrueshme zbatimin e rregullores tonë. Kështu që edhe unë jam dakord me propozimin e zotit Toska. Faleminderit!

**Naureda Llagami:** Faleminderit, zonja Kadi!

Duke qenë se na janë bërë disa propozime, kemi ndonjë diskutim tjetër?

**Marçela Shehu:** Desha të shprehem edhe unë Kryetare, nëse mundem.

**Naureda Llagami:** Po, Marçela!

**Marçela Shehu:** Atëherë, për të mos përsëritur kolegët sepse mendoj që secili prej tyre në linjën përkatëse ishte shumë ezaurues në argumentin dhe arsyetimin përkatës. Unë doja të theksoja opinionin tim që përkon me atë çfarë ka propozuar edhe zonja Kadi, pasi jam edhe një nga ato anëtarët për të cilët zonja Kadi tha që ishin në grupin e propozuesve, për dy arsye shumë të thjeshta në fakt, unë mendoj që ligji 98/2016 përcakton shumë qartë se kush janë subjektet në këtë rast dhe unë mendoj që ne me një akt nënligjor nuk kemi hapësirë ligjore, nuk kemi hapësirë që të zgjerojmë këtë rreth subjektësh që përcakton ligji dhe as nuk kemi hapësirë për të justifikuar situata të tilla paligjshmërie, të cilat mbase për fajin e askujt, por gjithsesi janë ndodhur. E dyta, në momentin që Këshilli vendosi pezullimin e procedurave të mëtejshme të rekrutimit të punonjësve nëpër gjykata, nuk bëri gjë tjetër veçse mori këtë vendim pasi konstatoi paligjshmërinë deri në atë moment të realizimit të të gjitha këtyre procedurave. Ndaj në këtë moment, sot, mua më duket, mbase nuk do thoja jo logjike, por e paligjshme që në këtë moment ne t'i jepnim vlerë dhe të bënim të ligjshme disa veprime dhe disa procedura që në fakt ne vet i kemi konsideruar të paligjshme në momentin që e konstatuam këtë situatë dhe vendosëm pezullimin e mëtejshëm të këtyre procedurave që kishin nisur gjykatat.

Gjithashtu, theksoj që me propozimin e paraqitur, ashtu sikurse cituan edhe kolegët, në fakt nuk cenohet as interesi i këtyre punonjësve që mbase pa fajin e tyre janë rekrutuar në këtë mënyrë, por as interesi i gjykatës. Ata do të vijojnë të ushtrojnë në mënyrë të përkohshme sërish punën për të cilën ata janë marrë, por ndërkohë ata do t'i nënshtrohen realizimit të procedurave, ashtu siç kërkon ligji. Faleminderit, Kryetare!

**Naureda Llagami:** Faleminderit!

**Ilir Toska:** Mund ta kem fjalën?

**Naureda Llagami:** Po, zoti Toska!

**Ilir Toska:** Marr shkas nga diskutimi i zonjës Shehu, do desha të theksoj diçka që ka lidhje me mua, me qëndrimin që unë kam mbajtur, qoftë në momentin e pezullimit, qoftë në ditën e sotme, do desha t'ju kujtoj që Këshilli ka marrë vendimin e pezullimit, shkaku që unë kam votuar "pro" këtij vendimi, ka qenë pikërisht se do duhej të fillonte të

zbatohet ligji i ri që kishte hyrë në fuqi prej 4 vjetësh dhe Këshilli do duhej të ndërmerre me shpejtësi të gjitha hapat për të miratuar çdo akt nënligjor që ligji e ngarkon. Faleminderit!

**Naureda Llagami:** Faleminderit, zoti Toska!

Kemi ndonjë diskutim tjetër nga anëtarët?

**Alban Toro:** Edhe një ndërhyrje të fundit, nëse mundet në lidhje me interferencën e Kodit të Punës mbi ligjin aktual i cili rregullon marrëdhëniet e punës në shërbimin civil gjyqësor. Pak kohë më parë ne pezulluam tentativat që bënin kryetarët e gjykatave për të integruar kontrata pune për pozicione të cilat i nënshtrohen këtij ligji dhe pak kohë më parë, anëtarë të caktuar të Këshillit të Lartë Gjyqësor shprehën shqetësimin se pavarësisht se çdo gjë ishte pezulluar, kryetarë në detyrë të caktuar kishin shpallur hapjen ose ngarkimin e detyrës personave të caktuar, pra si të thuash, kishin nënshkruar kontrata të reja pune.

Jo pa qëllim ligji njuh rastet kur akti administrativ, megjithëse është miratuar nga organi kompetent, nuk merr fuqinë juridike, pranon shkaqet që e kanë ndërprerë këtë fuqi dhe një një nga shkaqet, përveç afatit, është edhe pezullimi, i cili është një moment juridik që ndërpret në mënyrë të menjëhershme dhe kërkon fuqinë juridike të aktit. Dhe pikërisht këtë vendimmarrje ne e bëmë sepse pamë që aktualisht po spekulohet me justifikimin që na duhen njerëz në gjykata, ndërkohë që në gjykata pothuajse janë të shkatërruara, nuk ka gjyqtarë dhe nuk kuptoj rëndësinë apo shpejtësinë që i duhej punësimi i ri në funksion të një gjykate e cila nuk është në efikasitet. Kështu që në këtë kontekst unë do të thoja që ndryshimi i propozuar do të ishte shumë i vlefshëm për të mos krijuar kontradikta më pas në respektimin e këtij akti nënligjor. Faleminderit!

**Naureda Llagami:** Faleminderit, zoti Toro!

Atëherë, nëse nuk keni ndonjë diskutim nga kolegët, unë konstatoj që kemi 4 propozime konkrete dhe sugjeroj që t'i hedhim në votim, përpara se të hedhim në tërësi votimin e projekt-aktit. Nga praktika që kemi vendosur, fillojmë me propozimin mbi të cilin ka më shumë...

**Fatmira Luli:** Më fal Naureda, të bëj dhe një propozim për saktësimin e atij propozimit të Erjonit, se shoh që ka një pasaktësi. Pastaj të hidhet në votim.

Bëhet fjalë për pikën 3/c të nenit 4 ku kemi thënë: “për pozicionin e nëpunësit zbatues/drejtues (që është drejtuesi i buxhetit në gjykata) duhet të përmbushë kriteret e përcaktuara në legjislacionin përkatës për menaxhimin financiar (që ky është ligj i posaçëm) dhe kontrollin, të cilët kanë përfunduar studimet e ciklit të dytë në “Master shkencor” ose zotëron diplomë universitare të ekuivalentuar...” dhe pikën /ç/ të themi “në “Master profesional””. Kërkojnë korrigjim /c/-ja dhe /ç/-ja.

**Naureda Llagami:** Atëherë, neve do ta reflektojmë.

Do të hedhim në votim propozimin e Erjonit për pikën /c/ dhe /ç/ për pikën 3 të nenit 4.

**Erjon Muharremaj:** Mundem?

Unë jam dakord me qëndrimin e zonjës Luli, kështu që e tërheq propozimin tim.

**Naureda Llagami:** Dakord.

Kalojmë tani tek propozimet që kemi.

Fillimisht kemi një propozim i cili është ngritur nga shumica e kolegëve, që bëhet fjalë për heqjen e nenit 11 të dispozitës tranzitore.

Atëherë, kalojmë në votim të këtij propozimi? Propozim i ardhur nga zonja Kadi, i pranuar nga zonja Ukperaj, pranuar nga zoti Toska. Fillimisht fillojmë me votimin e këtij propozimi që ka të bëjë me heqjen e nenit 11 të projekt-aktit “Dispozita tranzitore”. Jemi dakord?

**Maksim Qoku:** Dakord.

**Brunilda Kadi:** Dakord.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Ilir Toska:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Dakord.

**Marçela Shehu:** Dakord.

**Erjon Muharremaj:** Pro.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Medi Bici:** Pro.

**Naureda Llagami:** Dakord.

Atëherë, miratohet propozimi.

Kalojmë tek propozimi i dytë i cili ka të bëjë me propozimin e iniciuar nga zoti Muharremaj dhe më pas të pranuar nga relatorja e projekt-aktit dhe për eferkt të reflektimit në projekt-akt ne po e hedhim në votim, pra që ka të bëjë me ndryshimin e nenit 4, pika 3/c dhe 3/ç. Jemi dakord?

**Brunilda Kadi:** Formulojeni përfundimisht si do jetë. Le ta lexojë dikush ose Erjoni ose Fatmira.

**Fatmira Luli:** E lexoj unë, nuk është problem. E lexova.

**Naureda Llagami:** E lexoi Fatmira dhe mendova se e keni të qartë.

Për përsëritje, patjetër! – Fatmira, lexoje edhe një herë.

**Fatmira Luli:** E lexoj unë.

Neni 4, pika 3/c, projekti që hidhet për votim: “c) për pozicionin e nëpunësit zbatues/drejtues i buxhetit punonjësi në detyrë duhet të përmbushë kriteret e përcaktuara në legjislacionin përkatës për menaxhimin financiar dhe kontrollin, të cilët kanë përfunduar studimet e ciklit të dytë në “Master shkencor” ose zotëron diplomë universitare të ekuivalentuar me të, me përvojë pune jo më pak se pesë vjet në profesion” dhe pika /ç/ duhet të jetë “ç) për pozicionin e nëpunësit/specialistit të financës dhe të buxhetit: i) të jetë i diplomuar në shkencë ekonomike, të paktën në nivelin “Master profesional”, ose të barasvlershëm me të, ose sipas përcaktimeve të legjislacionit të arsimit të lartë”. Ky është propozimi.

**Brunilda Kadi:** Më fal Kryetare, sepse ndoshta nuk u diskutua, unë personalisht thashë që jam dakord me propozimin që tha zoti Toska duke vënë profesional dhe shkencor. Se çfarë ndodh? Mund të jetë dikush që e ka shkencor masterin, s’e ka profesional dhe... që të jetë e qartë. Profesional është më poshtë sesa shkencori. Por në qoftë se ti nuk e citon, mund të konfundohej. Le t’i vëmë të dyja.

**Fatmira Luli:** Duke qenë më i ulëti Bruna, presupozohet që i larti ka përparësi.



**Brunilda Kadi:** Në diskutim nivel akademik është kjo ndarja Mira. Është më mirë ta vëmë në rregullore. Është më mirë të jetë më e qartë. Pra t'i vëmë të dyja profesional/shkencor ose ekuivalent me to.

**Fatmira Luli:** Kam hall se mos keqkuptohet po të vihen të dyja dhe ta konsiderojnë si pengesë.

**Brunilda Kadi:** Profesional ose shkencor.

Unë them që të jenë të dyja, atë që propozoi zoti Toska.

**Marçela Shehu:** Edhe unë mendoj që të jenë të dyja sepse “Masteri profesional” të jetë si kriter minimal, ndërsa “Masteri shkencor” i bie që është kriteri maksimal që mund të plotësojë kandidati. Por që të jetë sa më e qartë dhe mos të krijojë konfundime apo interpretime të gabuara, le të jenë të dyja.

**Fatmira Luli:** Fjala “të paktën” tek pika /ç/, tregon që ai është minimumi i kërkesave. Kur thua “Master profesional”, ke marrë minimumin dhe presupozon që “Masteri shkencor” është brenda dhe është i privilegjuar personi që e ka. Në të kundërt duhet të heqim fjalën “të paktën” dhe të themi “të ketë”. Vet fjala “të paktën” tregon që minimumi që duhet të ketë ai është “Masteri profesional”.

**Marçela Shehu:** Le të na sqarojnë pak profesorët që kemi në Këshill.

**Erjon Muharremaj:** Prandaj e kam kërkuar fjalën.

**Naureda Llagami:** Erjon!

**Erjon Muharremaj:** Faleminderit!

Atëherë, formulimi që bëri zoti Toska ishte i saktë: “Masteri shkencor” ose i barasvlershëm me të - sepse mund të ketë kualifikime të tjera që janë bërë jashtë shtetit që janë njehsuar si të tilla me “Masterin shkencor” - ose “Master profesional me të njëjtin numër kreditesh, përmenda unë. Që do të thotë që kur ka 120 kredite është i barasvlershëm me atë që parashikon edhe ligji “Për arsimin e lartë” për sa i përket numrit të krediteve. Pra të jenë të dyja dhe kështu del më e qartë.

**Brunilda Kadi:** Më fal, dua të shtoj diçka.

Pavarësisht se ne mund të biem dakord dhe mund të jetë e qartë që “Masteri shkencor” në nivel akademik është më lart sesa profesionali, mund të keqinterpretohet sepse ndoshta do thuhet: “Ah, po ky është specifik dhe ne masteri na duhet profesional

dhe jo shkencor, sepse ka lidhje me praktikën”, dhe kjo mund t’i konfundojë në qoftë se ne nuk e vëmë të qartë në rregullore. Mund të ndodhë kazusi që ai e ka shkencor dhe nuk e ka profesional dhe mund t’i thuhet që rregullorja e kërkon profesional sepse e do specifik. Kështu që, është më mirë t’i vëmë të dyja.

**Fatmira Luli:** Atëherë, të heqim fjalën “të paktën” dhe të vazhdojmë formulimin me propozimin e shumicës. Të heqim fjalën “të paktën” në pikën /ç/.

**Ilir Toska:** Kam përshtypjen që zoti Muharremaj e bëri saktësisht formulimin. Mund të hedhim atë në votim.

**Erjon Muharremaj:** Të sqaroj diçka në lidhje me këtë që sapo sqaroi zonja Luli në lidhje me heqjen e termit “të paktën”, nëse hiqet ky term eventualisht në një rast hipotetik, nëse kemi dikë me Doktoraturë, në qoftë se heq termin “të paktën” dhe mbetet vetëm “Master shkencor” ose profesional, atëherë ti përjashton ato që kanë Doktoraturë, që është një nivel akoma edhe më i lartë, - hipotetikusht flasim tani (nëse dikush për një pozicion të tillë do të kishte një kualifikim të tillë).

Kështu që heqja e termit “të paktën” nuk më duket korrekte.

**Maksim Qoku:** Erjon, kush ka marrë Doktoraturën, nuk diskutohet që ka “Masterin shkencor”. Nuk ke Doktoraturë po s’kalove në sistemin “Master”. Problemi është, ne të dy të kuptojmë këtë gjë, -Si do sillemi kundrejt “Masterit profesional” me 60 kredite? Do ta përjashtojmë? Pra “Master profesional” me 120 kredite vetëm? Sepse “Masteri profesional” ka edhe 60 kredite. E kuptove ç’dua të them?

**Erjon Muharremaj:** Po, po, - e qartë!

Po nëse pranojmë edhe “Masterin profesional” me 60 kredite, atëherë termi “i barasvlershëm” e humbet kuptimin.

**Maksim Qoku:** Ligji “Për arsimin e lartë” e ka në kuptimin e atyre studimeve jashtë shtetit që nuk kanë emërtimin “Master” por që neve kur i njohim, i barasvlerësojmë me kreditë (60 apo 120), dhe unë e kuptoj në fakt këtë, që meqë jemi në aspektin e një pozicioni nëpunësi, nuk ka pse të bëhemi kaq pedant dhe të përjashtojmë “Masterin profesional” me 60 kredite. Prandaj dhe them që mos ta përmendim “Master profesional” me aq apo kaq kredite, por ta lëmë “Master profesional”. Formulimi të jetë,

nuk e heqim “të paktën”, por “në nivelin “Master shkencor”, “Master profesional” apo të barasvlershëm me të.

**Naureda Llagami:** Nejse, ne gjithsesi po dalim jashtë kësaj që thotë ligji, se ligji thotë ““Master shkencor” ose të barasvlershëm me të” dhe ky është kriter ligjor në fakt. Po të shkojmë tek ligji për pushtetin gjyqësor...

**Fatmira Luli:** E thotë për drejtuesin pra.

Ne ramë dakord që drejtuesi është “nëpunësi zbatues” sipas ligjit “Për menaxhimin financiar”, ndërsa specialisti do “Master profesional”.

**Maksim Qoku:** Pra nuk jemi në kundërshtim me ligjin.

**Naureda Llagami:** Atëherë, Erjon mund të na e bësh edhe një herë formulimin, si pedagog Profesor. Ne do themi tek pika /c/ “c) për pozicionin e nëpunësit zbatues/drejtues i buxhetit punonjësi në detyrë duhet të përmbushë kriteret e përcaktuara në legjislacionin përkatës për menaxhimin financiar dhe kontrollin, të cilët kanë përfunduar studimet e ciklit të dytë... të llojit “Master shkencor”?

**Brunilda Kadi:** Për nëpunësin ramë dakord që do jetë “Master profesional”.

**Maksim Qoku:** Po! - pa i përmendur numër kreditesh.

**Naureda Llagami:** Bruna, na ktheve tek pika e dytë.

Jemi tek pika e parë tek drejtuesit.

**Brunilda Kadi:** Për pikën e parë ishim dakord pra. Për dyshin po diskutojmë.

**Fatmira Luli:** Korrigjuam edhe gabim tek pika e parë.

**Naureda Llagami:** Edhe e para kishte gabim. Do i hedhim në votim të dy pikat.

**Fatmira Luli:** Ramë dakord për “Master shkencor”, jo studime në shkencat ekonomike, se shkenca ekonomike janë të gjitha.

**Naureda Llagami:** Pikërisht pra.

“... kanë përfunduar “Master shkencor” ose zotëron diplomë universitare të ekuivalentuar me të, me përvojë pune jo më pak se pesë vjet në profesion”.

**Brunilda Kadi:** Hedhim fillimisht këtë në votim Kryetare dhe pastaj pikën 2, meqenëse edhe Erjoni me Maksin kishin dy variante të ndryshme.

**Naureda Llagami:** Dakord. Hedhim këtë pikën kështu pra, që në vend të “...studimet e ciklit të dytë në shkenca ekonomike...” të themi ““Master shkencor” në shkencat ekonomike...”. Kjo është logjika?

E hedhim në votim këtë pikë sipas këtij formulimi të bërë.

**Maksim Qoku:** Dakord.

**Brunilda Kadi:** Dakord.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Illir Toska:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Dakord.

**Marçela Shehu:** Dakord.

**Erjon Muharremaj:** Pro.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Medi Bici:** Pro.

**Naureda Llagami:** Dakord.

Atëherë, kalojmë tek pika tjetër që ka të bëjë me pozicionin e nëpunësit të financës dhe të buxhetit, ku është parashikuar “...të jetë i diplomuar në shkenca ekonomike, të paktën në nivelin "Master shkencor" ose të barasvlershëm me të, sipas përcaktimeve të legjislacionit të arsimit të lartë;”, kjo është motamo që thotë ligji.

Tani shtesa që ne mendojmë për qartësi kush do ishte Erjon?

**Erjon Muharremaj:** Tani, unë propozimin e kisha bërë...

Jemi tek cili nënparagraf tani?

**Maksim Qoku:** Tek /ç/-ja Erjon.

Nën paragrafi /i/.

**Erjon Muharremaj:** Po pra, “...të jetë i diplomuar në shkenca ekonomike, të paktën në nivelin "Master shkencor" ose të barasvlershëm me të, ose “Master profesional”...”.

**Naureda Llagami:** Tani këtë gjë që shtojmë ne ligji nuk e ka.

A është në frymën e legjislacionit të arsimit të lartë kjo gjë?

**Fatmira Luli:** Po, po! – është në rregull.

**Maksim Qoku:** Është në frymën e ligjit.

**Naureda Llagami:** Atëherë e shtojmë.

Jemi dakord me këtë propozim që shtohet?

**Maksim Qoku:** Të votojmë?

**Naureda Llagami:** Po! - kalojmë në votim.

**Maksim Qoku:** Dakord.

**Brunilda Kadi:** Propozimi ishte që do shtojmë “Masterin profesional”?

**Fatmira Luli:** Po!

**Brunilda Kadi:** Me 120 kredite?

**Maksim Qoku:** Jo, jo! – pa kredite.

**Brunilda Kadi:** Varianti që tha Maksi. Okej!

Unë jam dakord me këtë variantin, pra pa kredite.

**Maksim Qoku:** Pa kreditë, se nëpunës është ai.

**Brunilda Kadi:** Dakord.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Ilir Toska:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Dakord, duke u saktësuar ndoshta nëpunës/specialist, që të kuptohet që është specialist i buxhetit dhe financës.

**Marçela Shehu:** Dakord.

**Erjon Muharremaj:** Pro.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Medi Bici:** Pro.

**Naureda Llagami:** Dakord.

Kalojmë tek propozimi tjetër i cili ka të bëjë me nenin 6, pika 5 për togfjalëshin “Gjykata Administrative e Apelit”, të përdoret vetëm termi “gjykata kompetente”, siç referon ligji, neni 87. Jemi dakord me këtë? Është propozim i ardhur nga zonja Ukperaj, dakordësuar edhe nga zoti Toska.

**Maksim Qoku:** Dakord.

**Brunilda Kadi:** Dakord.

***Dritan Hallunaj***: Pro.

***Illir Toska***: Dakord.

***Alban Toro***: Dakord.

***Fatmira Luli***: Dakord.

***Marçela Shehu***: Dakord.

***Erjon Muharremaj***: Pro.

***Brikena Ukperaj***: Pro.

***Medi Bici***: Pro.

***Naureda Llagami***: Dakord.

Miratohet edhe ky ndryshim në nenin 6.

E fundit është formulimi i ardhur nga zonja Kadi dhe nga dy anëtarët e tjerë, zonja Shehu dhe zoti Toro.

Jeni dakord që neni 2 të ndryshohet sipas propozimit të zonjës Kadi?

***Maksim Qoku***: Kundër.

***Brunilda Kadi***: Dakord.

***Dritan Hallunaj***: Kundër.

***Illir Toska***: Kundër.

***Alban Toro***: Dakord.

***Fatmira Luli***: Dakord.

***Marçela Shehu***: Dakord.

***Erjon Muharremaj***: Kundër.

***Brikena Ukperaj***: Kundër.

***Medi Bici***: Kundër.

***Naureda Llagami***: Kundër.

Atëherë rrëzohet propozimi i ardhur nga zonja Kadi.

Kalojmë në tërësi me të gjithë ndryshimet që u pranuan me propozimet e projekt-aktit.

***Maksim Qoku***: Dakord.

***Brunilda Kadi***: Dakord.

***Dritan Hallunaj***: Pro.

**Ilir Toska:** Dakord.

**Alban Toro:** Pjesërisht pro, përveç atij propozimit të nenit 2 që shpreha votën “pro”. Faleminderit!

**Fatmira Luli:** Pro pjesërisht, e kemi lënë pa dispozitë tranzitore dhe ka ngelur ligji pa përcaktuar kohën kur do konsiderohen nëpunës civilë gjyqësorë. Pjesërisht dakord.

**Marçela Shehu:** Pro pjesërisht, përveç ndryshimeve të propozuara për pikën 2.

Edhe një sugjerim të lutem Kryetare!

Kur hedhim në votim propozimet, të mos shprehemi “propozimi u rrëzua”, por mbase “nuk u miratua” do të ishte më e përshtatshme për mbledhjen. Faleminderit!

**Erjon Muharremaj:** Pro.

Në lidhje me këtë të fundit, unë mendoj që në votim mund të ketë vetëm “pro” ose “kundër”. Nuk e di sesi mund të ketë “pro pjesërisht” ose “kundër pjesërisht”. Faleminderit!

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Medi Bici:** Pro.

**Naureda Llagami:** Dakord.

Atëherë, Këshilli miratoi projektvendimin “Për përcaktimin e kritereve dhe procedurave për dhënien e statusit të nëpunësit civil gjyqësor, punonjësve në detyrë në gjykata”, sipas propozimit të bërë nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit dhe propozimeve të miratuara nga Këshilli për ndryshimet.

\* \* \*

(Pika e 3 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2020

**PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 24.09.2020)*

**Pika 4 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimeve të përgatitura nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës:

4.1 Për përfshirjen e kandidatës znj. {...}, në procedurat e komandimit si ndihmësmagjistrat pranë Gjykatës së Lartë (relatore znj. Marçela Shehu).

4.2 Për përjashtimin e kandidatës znj. {...}, nga procedurat e komandimit si ndihmësmagjistrat pranë Gjykatës së Lartë (relatore znj. Marçela Shehu).

4.3 Për përjashtimin e kandidatit z. {...}, nga procedurat e komandimit si ndihmësmagjistrat pranë Gjykatës së Lartë (relatore znj. Marçela Shehu).

4.4 Për përfshirjen e kandidatës, znj. {...}, në procedurat e komandimit si ndihmësmagjistrat pranë Gjykatës së Lartë (relator z. Alban Toro).

4.5 Për përfshirjen e kandidatës znj. {...}, në procedurat e komandimit si ndihmësmagjistrat pranë Gjykatës së Lartë (relator z. Alban Toro).

4.6 Për përfshirjen e kandidatës, znj. {...}, në procedurat e komandimit si ndihmësmagjistrat pranë Gjykatës së Lartë (relator z. Alban Toro).

4.7 Për përjashtimin e kandidatit z. Florian {...}, nga procedurat e komandimit si ndihmësmagjistrat pranë Gjykatës së Lartë (relator z. Alban Toro).

4.8 Për përjashtimin e kandidatit z. {...}, nga procedurat e komandimit si ndihmësmagjistrat pranë Gjykatës së Lartë (relator z. Alban Toro).

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***



*Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:08 dhe mbaroi në orën 13:20.*

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- |                             |                          |
|-----------------------------|--------------------------|
| <i>1. Naureda Llagami</i>   | <i>(kryetare)</i>        |
| <i>2. Maksim Qoku</i>       | <i>(zëvendëskryetar)</i> |
| <i>3. Medi Bici</i>         | <i>(anëtar)</i>          |
| <i>4. Fatmira Luli</i>      | <i>(anëtare)</i>         |
| <i>5. Brunilda Kadi</i>     | <i>(anëtare)</i>         |
| <i>6. Dritan Hallunaj</i>   | <i>(anëtar)</i>          |
| <i>7. Ilir Toska</i>        | <i>(anëtar)</i>          |
| <i>8. Alban Toro</i>        | <i>(anëtar)</i>          |
| <i>9. Brikena Ukperaj</i>   | <i>(anëtar)</i>          |
| <i>10. Marçela Shehu</i>    | <i>(anëtare)</i>         |
| <i>11. Erjon Muharremaj</i> | <i>(anëtar)</i>          |

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 2. Helena Papa, Drejtore pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 3. Pjerin Prendi, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 4. Aleksandër Çavo, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 5. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
- 6. Pjesë nga stafi administrativ i Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 7. Entela Dobi, përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
- 8. Përfaqësues të Misionit EURALIUS dhe Projektit të “USAID”.*

#### **RENDI I DITËS:**

4. Shqyrtimi i projektvendimeve të përgatitura nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës:
  - 4.1 Për përfshirjen e kandidatës znj. {...}, në procedurat e komandimit si ndihmësmagjistrat pranë Gjykatës së Lartë (relatore znj. Marçela Shehu).

4.2 Për përjashtimin e kandidates znj. {...}, nga procedurat e komandimit si ndihmësmagjistrat pranë Gjykatës së Lartë (relatore znj. Marçela Shehu).

4.3 Për përjashtimin e kandidatit z. {...}, nga procedurat e komandimit si ndihmësmagjistrat pranë Gjykatës së Lartë (relatore znj. Marçela Shehu).

4.4 Për përfshirjen e kandidates, znj. {...}, në procedurat e komandimit si ndihmësmagjistrat pranë Gjykatës së Lartë (relator z. Alban Toro).

4.5 Për përfshirjen e kandidates znj. {...}, në procedurat e komandimit si ndihmësmagjistrat pranë Gjykatës së Lartë (relator z. Alban Toro).

4.6 Për përfshirjen e kandidates, znj. {...}, në procedurat e komandimit si ndihmësmagjistrat pranë Gjykatës së Lartë (relator z. Alban Toro).

4.7 Për përjashtimin e kandidatit z. Florian {...}, nga procedurat e komandimit si ndihmësmagjistrat pranë Gjykatës së Lartë (relator z. Alban Toro).

4.8 Për përjashtimin e kandidatit z. {...}, nga procedurat e komandimit si ndihmësmagjistrat pranë Gjykatës së Lartë (relator z. Alban Toro).

**Naureda Llagami:** Kalojmë në shqyrtimin e projektvendimeve nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, lidhur me përfshirjen e kandidates znj. {...}, në procedurat e komandimit si ndihmësmagjistrat pranë Gjykatës së Lartë.

Për më shumë detaje fjalën ia jap zonjës Marçela Shehu.

**Marçela Shehu:** Faleminderit, Kryetare!

Siç jeni në dijeni, Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar edhe në kërkesën e Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 258, 23.07.2020 ka vendosur hapjen e procedurës së komandimit të gjyqtarit në pozicionin e ndihmësmagjistratit në Gjykatën e Lartë, shpalljen e kërkesës për kandidatura nga radhët e gjyqtarëve për komandim në Gjykatën e Lartë për 5 pozicione të lira si ndihmësmagjistrat. Afati i paraqitjes së kërkesës për këtë komandim është përcaktuar deri më datën 04.09.2020.

Brenda afatit të paraqitjes së kërkesave për komandim, pranë Këshillit ka paraqitur kërkesë znj. {...}, gjyqtare pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Korçë.

Pas këtij momenti, në referim të nenit 54, të ligjit 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” si dhe në referim të vet vendimit të Këshillit nr. 258, datë 23.07.2020, KZHK ka përgatitur një projekt-opinion për këtë kandidatë lidhur me cenimin ose jo të funksionalitetit të gjykatës nga e cila vjen kjo kandidatë, në rastin hipotetik të kandidimit të saj si ndihmësmagjistrate pranë Gjykatës së Lartë.

Me qëllim dhënien e përgatisje së këtij projekt-opinionit është kërkuar informacion nga gjykata, i është marrë një mendim kryetarit të gjykatës si dhe një informacion nga Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit.

Nga informacioni i marrë ka rezultuar se kjo gjykatë ka në organikë 4 gjyqtarë. Ka një ngarkesë çështjesh mesatare. Prej datës 1 janar 2020 deri në 1 shtator 2020 janë regjistruar 944 çështje së bashku me çështjet e mbartura. Janë gjykuar 758 çështje dhe aktualisht deri sot më datë 1 shtator 2020 janë në gjykim 186 çështje gjyqësore. Gjyqtarja {...} rezulton që deri në datën 1 shtator 2020 ka në proces gjykimi 32 çështje gjyqësore dhe pak a shumë ky është trendi i çështjeve që kanë në gjykim edhe tre gjyqtarët e tjerë të kësaj gjykate.

Bazuar në këtë informacion, pra në numrin e çështjeve që janë në gjykim pranë kësaj gjykate, në numrin e çështjeve që janë në gjykim pranë çdo gjyqtari, referuar edhe faktit që kjo gjykatë punon me organikë të plotë, Komisioni ka vlerësuar se komandimi i kësaj gjyqtareje nuk cenon funksionalitetin e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Korçë, ku kjo gjyqtare ushtron detyrën. Ky projekt-opinion përputhet edhe me mendimin që ka dhënë edhe Kryetari i kësaj gjykate.

Në këto kushte, Komisioni ka përgatitur edhe projektvendimin përkatës, duke i propozuar Këshillit të Lartë Gjyqësor miratimin e opinionit për kandidaten, gjyqtaren {...} dhe publikimin e këtij opinionit në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Faleminderit!

*Naureda Llagami:* Faleminderit, zonja Shehu!

Atëherë, kemi ndonjë diskutim lidhur me projekt-aktin?

Nëse jo, kalojmë në votimin e tij?

**Maksim Qoku:** Dakord.

**Brunilda Kadi:** Dakord.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Ilir Toska:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Dakord.

**Marçela Shehu:** Dakord.

**Erjon Muharremaj:** Pro.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Medi Bici:** Pro.

**Naureda Llagami:** Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi miratimin e opinionit për kandidaten, gjyqtaren {...} e cila ushtron funksionin e saj pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Korçë. Publikimin e këtij opinionit në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e publikimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

**Naureda Llagami:** Atëherë, kalojmë tek çështja e radhës e cila ka të bëjë me projekt-aktin sa i përket përjashtimit të kandidates znj. {...}, nga procedurat e komandimit si ndihmësmagjistrat pranë Gjykatës së Lartë.

Edhe për këtë projekt-akt relatore është zonja Marçela Shehu.

**Marçela Shehu:** Faleminderit, Kryetare!

Ashtu sikur u citua edhe në relacionin paraardhës, Këshilli i Lartë Gjyqësor, me vendimin nr. 258, datë 23.07.2020 ka vendosur hapjen e procedurës së komandimit të gjyqtarit në pozicionin e ndihmësmagjistratit në Gjykatën e Lartë duke shpallur kështu kërkesën për kandidaturë nga radhët e gjyqtarëve. Afati i paraqitjes së kërkesës për këtë komandim është përcaktuar deri më datën 04.09.2020.

Një ndër gjyqtarët që ka aplikuar është edhe gjyqtarja {...}, e cila rezulton të jetë gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.

Në referim të nenit 54 të ligjit 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” si dhe në referim të vendimit nr. 258, datë 23.07.2020 të Këshillit, pika 11 e tij, KZHK ka përgatitur një projekt-opinion lidhur me cenimin e funksionalitetit të gjykatës nga vjen kjo gjyqtare duke iu referuar për këtë qëllim informacionit të marrë nga Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit, informacionit të marrë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier si dhe opinionit të dhënë nga kryetari i kësaj gjykate.

Nga këto informacione ka rezultuar që kjo gjykatë ka në organikë 15 gjyqtarë por efektivisht detyrën e ushtrojnë 9 gjyqtarë. Gjyqtari {...} deri më datë 31.08.2020 rezulton të ketë gjykuar 317 çështje, aktualisht ka në proces gjykimi 158 çështje. Gjyqtarja {...} aktualisht ka në proces gjykimi 156 çështje. Gjyqtari {...} ka në proces gjykimi 175 çështje. Gjyqtarja {...} aktualisht ka në proces gjykimi 104 çështje. Gjyqtarja {...} aktualisht ka në proces gjykimi 114 çështje. Gjyqtarja {...} ka në proces gjykimi 81 çështje. Gjyqtarja {...} ka në proces gjykimi 116 çështje. Gjyqtari {...} ka në proces gjykimi 176 çështje. Gjyqtari {...} ka në proces gjykimi 99 çështje.

Rezulton se gjyqtarët {...} dhe {...} janë aktualisht me leje lindje; gjyqtari {...} shërben si ndihmësmagjistrat pranë Gjykatës së Lartë; gjyqtari {...} është i pezulluar me vendim të Këshillit të Lartë Gjyqësor; ish-gjyqtari {...} është shkarkuar me vendimin nr. 150, datë 28.05.2019 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, lënë në fuqi nga Kolegji i Posaçëm i Apelit; gjyqtarja {...} me vendimin nr.317, datë 16.09.2020 të KLGJ-së është komanduar në skemën e delegimit të ngritur pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor për një afat deri në një vit.

Rezulton gjithashtu se me shkresën nr. 4356 prot., datë 15.09.2020, gjyqtarja {...} ka paraqitur një kërkesë pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor për t’u përfshirë në skemën e delegimit të ngritur pranë Këshillit e në këto kushte, pa e paragjykuar sigurisht vendimmarrjen e Këshillit, mund të jetë një kandidate potenciale për t’u pranuar në këtë skemë, duke konsideruar situatën e nevojave të gjykatave aktualisht. Në rastin hipotetik të pranimit të kësaj gjyqtareje në skemën e delegimit, numri i gjyqtarëve të kësaj gjykate do të shkonte në 8 gjyqtarë.

Në respektim të përcaktimit të bërë në nenin 54, lidhur me vlerësimin e Këshillit, nëse komandimi nuk është në përputhje me interesat e lartë të gjykatës ku gjyqtarja ushtron funksionin, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës ka vlerësuar, se në rastin konkret, komandimi i kësaj gjyqtareje vjen ndesh me interesat e larta të gjykatës ku ajo ushtron funksionin.

Duke konsideruar faktin që kjo gjykatë nuk funksionon me organikë të plotë pasi funksionin e gjyqtarit në këtë gjykatë aktualisht e ushtrojnë 9 gjyqtarë nga 15 që është organika; ngarkesën e lartë të çështjeve që rezultojnë aktualisht në gjykim pranë kësaj gjykate (rezulton një mesatare çështjesh në gjykim për gjyqtar prej 150 çështje); si dhe faktin që një nga gjyqtarët e kësaj gjykate, mund të jetë kandidatë potenciale për t'u përfshirë në skemën e delegimit, çka do ta çonte numrin e gjyqtarëve që ushtrojnë efektivisht detyrën, në 8.

Në këto kushte, Komisioni i propozon Këshillit të Lartë Gjyqësor përjashtimin e kësaj candidateje nga procedurat e komandimit si ndihmësmagjistrate pranë Gjykatës së Lartë. Faleminderit!

***Naureda Llagami:*** Faleminderit, zonja Shehu!

Nëse kolegët nuk kanë ndonjë kundërshtim apo sugjerim, kalojmë në votimin e projekt-aktit?

***Maksim Qoku:*** Dakord.

***Brunilda Kadi:*** Dakord.

***Dritan Hallunaj:*** Pro.

***Ilir Toska:*** Dakord.

***Alban Toro:*** Dakord.

***Fatmira Luli:*** Dakord.

***Marçela Shehu:*** Dakord.

***Erjon Muharremaj:*** Pro.

***Brikena Ukperaj:*** Pro.

***Medi Bici:*** Pro.

***Naureda Llagami:*** Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi përjashtimin e kandidates znj. {...}, nga procedurat e komandimit si ndihmësmagjistrate pranë Gjykatës së Lartë për shkak të cenimit të funksionalitetit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier. Publikimin e këtij opinionit në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e publikimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

**Naureda Llagami:** Kalojmë në projekt-aktin e radhës i cili ka të bëjë me projektvendimin “Për përjashtimin e kandidatit z. {...}, nga procedurat e komandimit si ndihmësmagjistrat pranë Gjykatës së Lartë”.

Edhe për këtë projekt-akt relatore është sërish zonja Shehu.

**Marçela Shehu:** Edhe gjyqtari {...} ka kandiduar për pozicionin e ndihmësmagjistratit në Gjykatën e Lartë, pas thirrjes së bërë nga Këshilli i Lartë Gjyqësor me vendimin nr. 258, datë 23.07.2020.

Edhe për zotin Pina është përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës një projekt-opinion lidhur me cenimin ose jo të funksionalitetit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, në rastin hipotetik të komandimit të këtij gjyqtari pranë Gjykatës së Lartë.

Me qëllim hartimin e këtij projekt-opinionit është marrë një informacion nga Departamenti i Burimeve Njerëzore pranë Këshillit, nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë dhe një mendim nga zëvendëskryetari në detyrë.

Nga informacioni i marrë ka rezultuar se kjo gjykatë ka në organikë 6 gjyqtarë, por efektivisht e ushtrojnë detyrën 4 gjyqtarë. Ngarkesa me çështjet në gjykim për secilin gjyqtar paraqitet e tillë: Gjyqtari {...} deri me datë 10 shtator 2020 ka gjykuar 283 çështje, aktualisht ka në proces gjykimi 143 çështje. Gjyqtarja {...} ka gjykuar 307 çështje, aktualisht ka në proces gjykimi 240 çështje. Gjyqtarja {...} ka në proces gjykimi 205 çështje. Gjyqtari {...} ka në proces gjykimi 162 çështje.

I është marrë një opinion kryetarit në detyrë pranë kësaj gjykate. Në këtë opinion rezulton se: “Në mungesë të kryetarit të gjykatës, në cilësinë e zëvendëskryetarit, vlerësoj

se aktualisht ngarkesa në punë është relativisht e lartë, por e shkaktuar nga fakti se brenda katër muajsh, u larguan dy gjyqtarë, konkretisht gjyqtarja {...} dhe gjyqtarja {...}, të cilat kishin në shqyrtim rreth 310 çështje (të dyja), që u shpërndanë ndërmjet katër gjyqtarëve. Po ashtu, ndikoi edhe pezullimi i veprimtarisë gjyqësore, si pasojë e pandemisë së shkaktuar nga virusi Covid-19. Kështu, vlerësoj se nëse brenda disa muajve emërohen gjyqtarë të rinj, situata kthehet në normalitet.

Ndërsa funksionin e zëvendëskryetarit mund ta ushtrojë gjyqtarja {...}, e cila i plotëson të gjitha kriteret dhe ka eksperiencën e duhur (është e vetmja që mbetet pasi dy gjyqtarët e tjerë nuk i plotësojnë kriteret për t'u emëruar Zëvendëskryetar)".

Bëj me dije gjithashtu Këshillin se më datë 14.09.2020, pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor ka depozituar kërkesë për dorëheqje nga funksioni i magjistratit gjyqtarja {...} e cila ushtron detyrën e saj pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë.

Në këto kushte, KZHK, në referim të të gjithë këtyre informacioneve ka vlerësuar se duke u nisur nga fakti që kjo gjykatë nuk funksionon me organikë të plotë pasi funksionin e gjyqtarit në këtë gjykatë aktualisht e ushtrojnë 4 gjyqtarë; duke konsideruar ngarkesën e lartë të çështjeve ku rezulton një mesatare çështjesh prej 180 çështje për gjyqtarë; duke konsideruar edhe faktin që gjyqtarja {...} ka paraqitur pranë Këshillit kërkesën e saj për dorëheqje dhe faktin që largimi i saj do të sillte një rritje të mëtejshme të ngarkesës së punës së gjyqtarëve të kësaj gjykate, vlerëson se komandimi i z. Pina si ndihmësmagjistrat në Gjykatën e Lartë, cenon interesat e larta të kësaj gjykate për shkak se cenohet funksionaliteti i saj, bazuar në shkaqet e cituara në këtë relacion. Nëse do të komandohej edhe zoti Pina, numri i gjyqtarëve që do të ushtronin aktualisht detyrën do të shkonte në 2, pas krijimit të efekteve ligjore të dorëheqjes së zonjës {...}, çka do ta bënte jofunksionale gjykatën.

Në këto kushte, Komisioni ka arritur pikërisht në këtë konkluzion, për t'i propozuar Këshillit përjashtimin e kandidatit nga procedurat e komandimit si ndihmësmagjistrat pranë Gjykatës së Lartë. Faleminderit!

*Naureda Llagami:* Faleminderit, zonja Shehu!



Kemi ndonjë diskutim?

Nëse jo, kalojmë në miratimin e projekt-aktit sipas propozimit të bërë nga relatorja dhe KZHK?

**Maksim Qoku:** Dakord.

**Brunilda Kadi:** Dakord.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Illir Toska:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Dakord.

**Marçela Shehu:** Dakord.

**Erjon Muharremaj:** Pro.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Medi Bici:** Pro.

**Naureda Llagami:** Dakord.

Këshilli vendosi përjashtimin e kandidatit z. {...}, nga procedurat e komandimit si ndihmësmagjistrat pranë Gjykatës së Lartë për shkak të cenimit të funksionalitetit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë. Publikimin e këtij opinioni në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e publikimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

**Naureda Llagami:** Kalojmë në projekt-aktin e radhës, i cili ka të bëjë me Për përfshirjen e kandidates, znj. {...}, në procedurat e komandimit si ndihmësmagjistrat pranë Gjykatës së Lartë.

Relatimi i këtij projekt-akti do bëhet nga zoti Alban Toro.

**Alban Toro:** Këshilli i Lartë Gjyqësor i është përgjigjur kërkesave të Gjykatës së Lartë për të komanduar gjyqtarë në pozicionin e ndihmësmagjistratit në Gjykatën e Lartë, duke hapur 5 pozicione të lira për ndihmësmagjistratët dhe kjo me vendimin nr. 258, 23.07.2020.

Një nga gjyqtarët që ka kandiduar është edhe zonja {...} e cila është gjyqtare e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë dhe e emëruar si e tillë me dekret të Presidentit 6623, datë 25.06.2010.

Në bazë të nenit 54 të ligjit 96/2016, në lidhje me procedurat e komandimit Këshilli i Lartë Gjyqësor ka detyrimin të vlerësojë funksionalitetin e gjykatës dhe cili është interesi më i lartë i gjykatës në raport me kryerjen e komandimit. Në respekt të këtij detyrimi nga ana e Komisionit është administruar informacioni përkatës nga ku rezulton se kjo gjykatë ka në organikë 4 gjyqtarë, aktualisht aty janë dekretuar dhe ushtrojnë funksionin efektivisht të katër gjyqtarët. Në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Krujë prej datës 1 janar 2020 deri në datën 11 shtator 2020 janë në gjykim 404 çështje gjyqësore. Gjyqtarja {...} ka një ngarkesë prej 114 çështje gjyqësore. Gjyqtarja {...} ka një ngarkesë prej 78 çështje gjyqësore. Gjyqtarja {...} ka një ngarkesë prej 115 çështje gjyqësore. Gjyqtarja {...} ka një ngarkesë prej 97 çështje gjyqësore.

Gjithashtu është administruar edhe opinioni i kryetares së gjykatës i cili ju është dërguar nëpërmjet e-mailit elektronik (i skanuar), kështu që nuk po humbas kohë.

Në përfundim të vlerësimit si të opinionit dhe të funksionalitetit të gjykatës, Komisioni ka arritur në konkluzionin se nuk kemi ndonjë cenim të interesave të lara të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë, për sa kohë nuk ka dëmtim të funksionalitetit të kësaj gjykate me komandimin e zonjës Tahiri, kështu që ka shprehur dakordësi dhe ka përgatitur projektin përkatës, të cilin e keni bashkëlidhur këtij relacioni, me anë të së cilës ju sugjerohet të miratoni opinionin për kandidaten gjyqtaren {...}, e cila ushtron funksionin e saj pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë. Publikimin e këtij opinionit në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Ky vendim hyn në fuqi në datën e publikimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Faleminderit!

**Naureda Llagami:** Faleminderit, zoti Toro!

Kalojmë në diskutim?

**Erjon Muharremaj:** Mund të them diçka zonja Kryetare?

Unë kisha një paqartësi në fakt në lidhje me mendimin e kryetares, por njëri nga kolegët me sqaroi në lidhje me këtë, kështu që tani mendoj që është e sqaruar kjo çështje. Faleminderit!

**Naureda Llagami:** Dakord.

Kalojmë në votimin e projekt-aktit, nëse nuk kemi diskutime?

**Maksim Qoku:** Dakord.

**Brunilda Kadi:** Dakord.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Illir Toska:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Dakord.

**Marçela Shehu:** Dakord.

**Erjon Muharremaj:** Pro.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Medi Bici:** Pro.

**Naureda Llagami:** Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi: Miratimin e opinionit për kandidaten, gjyqtaren {...} e cila ushtron funksionin e saj pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë. Publikimin e këtij opinionit në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e publikimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

**Naureda Llagami:** Kalojmë më pas në projekt-aktin e radhës, i cili ka të bëjë me përfshirjen e kandidates znj. {...}, në procedurat e komandimit si ndihmësmagjistrat pranë Gjykatës së Lartë.

Edhe për këtë projekt-akt, relator është zoti Toro.

**Alban Toro:** Po me vendimin nr. 258, 23.07.2020, KLGJ i është përgjigjur kërkesave të Gjykatës së Lartë për të komanduar gjyqtarë në pozicionin e ndihmësmagjistratit në Gjykatën e Lartë.

Një nga kandidatët ka qenë edhe zonja {...}, e cila është gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, e emëruar si e tillë me vendimin nr. 8, 09.01.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Nuk po citoj nenin 54 dhe detyrimet që ka Këshilli për të parë funksionalitetin sepse tashmë këto i ka relatuar edhe kolegia para meje por edhe unë pak më parë. Kështu që po dalë tek informacioni i administruar në kuadër të vlerësimit të funksionalitetit, nga ku rezulton se kjo gjykatë ka në organikë 14 gjyqtar, janë të dekretuar 13 gjyqtarë. Efektivisht aty ushtrojnë funksionin 11 gjyqtarë sepse një gjyqtar është i komanduar në Këshillin e Lartë Gjyqësor për një periudhë 2-vjeçare; një gjyqtar është emëruar në mënyrë të përkohshme për një periudhë 1-vjeçare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë. Në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë prej datës 1 janar 2020 deri në datën 10 shtator 2020 janë në gjykim 929 çështje gjyqësore, e ndarë si vijon: Gjyqtarja {...} ka një ngarkesë prej 120 çështje gjyqësore. Gjyqtari Arben Lara ka një ngarkesë prej 95 çështje gjyqësore. Gjyqtari Besnik Shehu ka një ngarkesë prej 86 çështje gjyqësore. Gjyqtarja {...} ka një ngarkesë prej 102 çështje gjyqësore. Gjyqtarja Luljeta Kole ka një ngarkesë prej 80 çështje gjyqësore. Gjyqtari {...} ka një ngarkesë prej 102 çështje gjyqësore. Gjyqtari {...} ka një ngarkesë prej 96 çështje gjyqësore. Gjyqtari {...} ka një ngarkesë prej 53 çështje gjyqësore. Gjyqtarja {...} ka një ngarkesë prej 101 çështje gjyqësore. Gjyqtari {...} ka një ngarkesë prej 94 çështje gjyqësore. Gjyqtarja {...} prej datës 06.03.2020 është me leje lindje dhe nuk ka asnjë çështje në gjykim”.

Pra duke parë ngarkesën e kësaj gjykate, personelin aktual dhe duke pasur parasysh që largimi apo vazhdimi i gjyqtares në kushtet kur ajo ka qenë me leje lindje nuk sjell ndonjë mbingarkesë të kësaj gjykate sepse kjo gjykatë vazhdon të funksionojë pa të, deri në këtë moment që po flasim, duke vlerësuar edhe opinionin e kryetares së gjykatës, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës vlerëson se komandimi i gjyqtares {...} në pozicionin e ndihmësmagjistrates në Gjykatën e Lartë nuk passjell cenim të interesit të lartë të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë dhe si të tillë ka paraqitur projektin bashkëlidhur, në të cilin ju propozohet: Miratimi i opinionit për kandidaten, gjyqtaren {...}, e cila ushtron funksionin e saj pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë. Publikimi i këtij opinionit në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Ky vendim hyn në fuqi në

datën e publikimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.  
Faleminderit!

**Naureda Llagami:** Faleminderit, zoti Toro!

Kemi ndonjë diskutim mbi projekt-aktin?

**Brunilda Kadi:** Po, Kryetare kam unë diçka.

Të lutem zoti Toro, mund të citohet pjesa konkluduese e kryetarit të gjykatës në lidhje me këtë?

**Alban Toro:** I tërë opinioni?

**Brunilda Kadi:** Jo, jo! - Pjesa konkluduese.

**Alban Toro:** Nëse i referoheni pjesës që kam përshkruar në relacion: “Lidhur me mendimin nëse komandimi i kësaj gjyqtare në pozicionin e këshilltares në Gjykatën e Lartë cenon ose jo funksionalitetin e Gjykatës, pas konsultimit me trupën gjyqësore në mbledhjen e radhës, referuar faktit që ngarkesa ka ardhur në rritje, organika është e paplotësuar me gjyqtarë, një gjyqtar është i komanduar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë, një gjyqtare është komanduar këshilltare pranë KLGJ-së, mendojmë që largimi i cilitdo gjyqtari do të cenonte veprimtarinë e rregullt dhe do të ndikonte në ngarkesën në punë të gjithsecilit, për rrjedhim edhe në cilësinë e aksesit të gjykatës. Duke pasur parasysh ngarkesën në punë edhe për gjykatat e tjera, ju mund të vlerësoni më drejt në lidhje me këtë aspekt”. –Kjo është pjesë nga opinioni.

**Brunilda Kadi:** Po, faleminderit!

Nuk kam gjë tjetër, faleminderit!

**Naureda Llagami:** Nëse nuk keni gjë tjetër, kalojmë në votimin e projekt-aktit?

**Maksim Qoku:** Dakord.

**Brunilda Kadi:** Kundër, me arsyetimin që, së pari mendoj që cenon interesat e gjykatës dhe së dyti, nga të gjithë informacionet që jepen për magistraten, ajo nuk ka gjykuar pothuajse asnjë çështje sepse menjëherë sa ka shkuar në gjykatë, që është

emëruar, ka marrë lejen e lindjes dhe nuk mendoj që është kandidat i përshtatshëm për këtë pozicion. Së pari ishte arsyeja që dhashë në fillim. Faleminderit! Pra jam kundër.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Ilir Toska:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Dakord.

**Marçela Shehu:** Dakord.

**Erjon Muharremaj:** Pro.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Medi Bici:** Pro.

**Naureda Llagami:** Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi: Miratimin e opinionit për kandidaten, gjyqtaren {...}, e cila ushtron funksionin e saj pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë. Publikimin e këtij opinionit në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e publikimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

**Naureda Llagami:** Kalojmë në projekt-aktin e radhës, i cili ka të bëjë me dhënien e opinionit për kandidaten, gjyqtaren {...}.

Edhe për këtë relator është zoti Alban Toro.

**Alban Toro:** Gjyqtare {...} ushtron funksionin pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnje, e caktuar si e tillë me vendimin nr. 135, 19.07.2019, të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Ajo konkurren për një nga pozicionet e hapura si ndihmësmagjistrate në Gjykatën e Lartë, shpalljen që është bërë me vendimin nr. 258, 23.07.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Në kuadër të vlerësimit të cenimit apo jo të funksionalitetit, nga ana e Komisionit është administruar informacioni përkatës, në të cilin rezulton se kjo gjykatë ka në organikë 5 gjyqtarë që aktualisht janë të dekretuar dhe ushtrojnë detyrën të 5 gjyqtarët. Në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lushnjë prej datës 1 janar 2020 deri në datën 09 shtator

2020 janë në gjykim 490 çështje gjyqësore, ndarë respektivisht si më poshtë: Gjyqtarja {...} ka një ngarkesë prej 78 çështje gjyqësore. Gjyqtarja {...} ka një ngarkesë prej 152 çështje gjyqësore. Gjyqtarja {...} ka një ngarkesë prej 84 çështje gjyqësore. Gjyqtarja {...} ka një ngarkesë prej 65 çështje gjyqësore. Gjyqtarja {...} ka një ngarkesë prej 111 çështje gjyqësore.

Është administruar edhe opinioni i kryetares së gjykatës e cila natyrisht shpreh shqetësimin me largimin eventual të saj, por gjithsesi lihet në vlerësim të KLGJ-së çmimi nëse priset apo jo funksionaliteti i gjykatës.

Duke vlerësuar sa më lart informacionin e administruar, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës çmon se komandimi i zonjës Çabej në pozicionin e ndihmësmagjistratit në Gjykatën e Lartë nuk passjell ndonjë cenim të interesit të lartë të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë dhe si të tillë ju propozon të miratoni opinionin përkatës dhe njëkohësisht projektin e përgatitur i cili parashikon se: Miratimin e opinionit për kandidaten, gjyqtaren {...} e cila ushtron funksionin e saj pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë. Publikimin e këtij opinionit në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Ky vendim hyn në fuqi në datën e publikimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Faleminderit!

**Naureda Llagami:** Kemi ndonjë diskutim mbi projekt-aktin?

Nëse jo, kalojmë në votimin e tij?

**Maksim Qoku:** Dakord.

**Brunilda Kadi:** Kundër, me arsyetimin se nisur edhe nga opinioni i kryetares së gjykatës dhe nga të dhënat statistikore, mendoj që cenon funksionalitetin e gjykatës largimi i magjistrates.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Ilir Toska:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Dakord.

**Marçela Shehu:** Dakord.

**Erjon Muharremaj:** Pro.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Medi Bici:** Pro.

**Naureda Llagami:** Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi: Miratimin e opinionit për kandidaten, gjyqtaren {...} e cila ushtron funksionin e saj pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë. Publikimin e këtij opinionit në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e publikimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

**Naureda Llagami:** Kalojmë në projekt-aktin e radhës i cili ka të bëjë me përjashtimin e kandidatit z. {...} nga procedurat e komandimit si ngihmësmagjistrat pranë Gjykatës së Lartë.

Edhe për këtë projekt-akt relator është zoti Toro.

**Alban Toro:** Edhe zoti {...} i cili është gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës, i emëruar si i tillë me vendimin nr. 15, datë 09.01.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor është një nga kandidatët për një nga pozicionet e shpallura nga Këshilli i Lartë Gjyqësor me vendimin nr. 258, datë 23.07.2020 për komandimin e gjyqtarit në pozicionin e ndihmësmagjistratit në Gjykatën e Lartë.

Në kuadër të vlerësimit të funksionalitetit është dërguar informacioni dhe është administruar informacioni përkatës në të cilin ka rezultuar se: Kjo gjykatë ka në organikë 4 gjyqtarë por ushtrojnë detyrën 3 gjyqtarë sepse një gjyqtar është i pezulluar si pasojë e rivlerësimit kalimtar. Në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kukës prej datës 1 janar 2020 deri në datën 9 shtator 2020 janë gjykuar 797 çështje dhe aktualisht deri sot më datë 9 shtator 2020 janë në gjykim 350 çështje gjyqësore. Gjyqtarit {...} i kanë kaluar përmes shortit 258 çështje gjyqësore. Ka gjykuar 160 çështje dhe aktualisht deri më datë 9 shtator 2020 ka në proces gjykimi 98 çështje gjyqësore. Gjyqtares {...} i kanë kaluar përmes shortit 388 çështje gjyqësore. Ka gjykuar 314 çështje dhe aktualisht ka në proces gjykimi 74 çështje gjyqësore. Gjyqtares {...} i kanë kaluar përmes shortit 501 çështje gjyqësore. Ka gjykuar 323 çështje dhe aktualisht ka në proces gjykimi 178 çështje gjyqësore.



Gjithashtu është administruar edhe opinioni i kryetarit, të cilin jam i detyruar ta citoj një pjesë të tij, për shkak se ka informacion të cilin duhet ta vlerësoni: “Në përgjigje të kërkesës Tuaj të datës 08.09.2020 për informacion plotësues të kërkuar nga ju, shpreh opinionin tim për rastin hipotetik të komandimit të Gjyqtarit {...} në Gjykatën e Lartë, duke ju bërë me dije se gjyqtarja znj. {...} është në muajin e katër të shtatzënisë dhe pas disa muaj do të marrë leje lindje, ndërsa gjyqtarja znj. {...} ka aplikuar për ngritje në detyrë dhe për këtë shkak është në procedurës të përshpejtuar të rivlerësimit nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit është e pamundur të parashikohet mbi mundësin e konfirmimit ose jo në detyrë. Është në vlerësimin tuaj nëse gjyqtari {...} duhet të komandohet pranë Gjykatës së Lartë si ndihmës magjistrat”.

Pra nga të dhënat e sipër cituara, rezulton në mënyrë të qartë se organika e kësaj gjykate për shkaqe ligjore mund të cenohet në një të ardhme të afërme duke kufizuar numrin e saj vetëm në një gjyqtar për këtë gjykatë. Për më tepër duke iu referuar edhe ngarkesës aktuale të çështjeve në gjykim ajo është e konsiderueshme edhe për numrin aktual të gjyqtareve në këtë gjykatë.

Kështu që, KZHK vlerëson se komandimi i z. {...} në pozicionin e ndihmësmagjistratit në Gjykatën e Lartë nuk është në përputhje me interesat më të larta të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës, dhe për këtë shkak ju ka propozuar projektin përkatës të cilin ju propozon ta miratoni dhe në dispozitivin e të cilit do të gjeni: Përrjashtimin e kandidatit z. {...}, nga procedurat e komandimit si ndihmësmagjistrat pranë Gjykatës së Lartë për shkak të cenimit të funksionalitetit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës. Publikimin e këtij opinioni në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e publikimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Faleminderit!

**Naureda Llagami:** Faleminderit, zoti Toro!

Atëherë, kemi ndonjë diskutim?

Nëse jo, kalojmë në votimin e projekt-aktit?

**Maksim Qoku:** Dakord.

**Brunilda Kadi:** Dakord.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Ilir Toska:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Dakord.

**Marçela Shehu:** Dakord.

**Erjon Muharremaj:** Pro.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Medi Bici:** Pro.

**Naureda Llagami:** Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi: Përjashtimin e kandidatit z. {...}, nga procedurat e komandimit si ndihmësmagjistrat pranë Gjykatës së Lartë për shkak të cenimit të funksionalitetit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës. Publikimin e këtij opinioni në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e publikimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

**Naureda Llagami:** Kalojmë në projekt-aktin e radhës, i cili ka të bëjë me përjashtimin e kandidatit, z. {...}, nga procedurat e komandimit si ndihmësmagjistrat pranë Gjykatës së Lartë.

Edhe për këtë projekt-akt relator është zoti Toro.

**Alban Toro:** Zoti {...} është gjyqtar pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër, i caktuar si i tillë me vendimin nr. 6, 09.01.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe është një nga konkurrentët për një nga 5 pozicionet si ndihmësmagjistrat për t'u komanduar në këtë pozicion në Gjykatën e Lartë.

Në kuadër të vlerësimit dhe detyrimit që parashikon neni 54 i ligjit 96/2016 në lidhje me funksionalitetin e gjykatës në momentin kur realizohet komandimi, nga ana jonë është administruar informacioni i cili mundëson vlerësimin e cenimit apo jo të funksionalitetit. Kjo gjykatë ka në organikë 4 gjyqtarë, aktualisht aty janë të dekretuar 4

gjqqtarë. Një gjyqtar është i pezulluar si pasojë e rivlerësimit kalimtar, gjithashtu është emëruar në mënyrë të përkohshme për një periudhë njëvjeçare një gjyqtar dhe aktualisht e bën përsëri 4 numrin e gjyqtareve që ushtrojnë efektimisht detyrën. Në Gjykatën Administrative e Shkallës së Parë Shkodër prej datës 1 janar 2020 deri në datën 9 shtator 2020 janë në ngarkim të gjyqtarëve 1907 çështje dhe aktualisht janë në gjykim 1381 çështje gjyqësore. Gjyqtarit {...} i kanë kaluar përmes shortit 471 çështje gjyqësore. Ka gjykuar 116 çështje dhe aktualisht deri më datë 9 shtator 2020 ka në proces gjykimi 355 çështje gjyqësore. Gjyqtarës {...} i kanë kaluar përmes shortit 483 çështje gjyqësore. Ka gjykuar 164 çështje dhe aktualisht deri më datë 9 shtator 2020 ka në proces gjykimi 7319 çështje gjyqësore. Gjyqtarit {...} prej datës 1 janar 2020 deri në datën 9 shtator 2020 i kanë kaluar përmes shortit 467 çështje gjyqësore. Ka gjykuar 53 çështje dhe aktualisht deri më datë 9 shtator 2020 ka në proces gjykimi 414 çështje gjyqësore. Gjyqtarit {...} prej datës 1 janar 2020 deri në datën 9 shtator 2020 i kanë kaluar përmes shortit 486 çështje gjyqësore. Ka gjykuar 193 çështje dhe aktualisht deri më datë 9 shtator 2020 ka në proces gjykimi 293 çështje gjyqësore”.

Në lidhje me opinionin e kryetarit në detyrë, të komanduar, shpreh dakordësinë që një gjyqtar të komandohet në Gjykatën e Lartë.

Por duke vlerësuar të dhënat e mësipërme si dhe opinionin e kryetarit në detyrë të komanduar, nga ana e Komisionit është vlerësuar se organika e kësaj gjykate, për shkaqe ligjore, mund të cenohet në një të ardhme të afërt dhe për më tepër, duke iu referuar edhe ngarkesës aktuale të çështjeve në gjykim ajo është e konsiderueshme edhe për numrin aktual të gjyqtarëve në këtë gjykatë.

Në këto kushte, Komisioni vlerëson se komandimi i zotit {...} në pozicionin e ndihmësmagjistratit në Gjykatën e Lartë, nuk është në përputhje me interesat e larta të Gjykatës Administrative e Shkallës së Parë Shkodër dhe për këtë qëllim ju propozon edhe projektvendimin përkatës, në dispozitivin e të cilit do të gjeni: Përjashtimin e kandidatit z. {...}, nga procedurat e komandimit si ndihmësmagjistrat pranë Gjykatës së Lartë për shkak të cenimit të funksionalitetit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër. Publikimin e këtij opinionin në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e publikimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Faleminderit!

**Naureda Llagami:** Faleminderit, Alban!

Keni ndonjë diskutim lidhur me projekt-aktin?

Nëse jo, kalojmë në votimin e tij?

**Maksim Qoku:** Dakord.

**Brunilda Kadi:** Dakord.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Illir Toska:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Dakord.

**Marçela Shehu:** Dakord.

**Erjon Muharremaj:** Pro.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Medi Bici:** Pro.

**Naureda Llagami:** Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi: Përfundimin e kandidatit z. {...}, nga procedurat e komandimit si ndihmësmagjistrat pranë Gjykatës së Lartë për shkak të cenimit të funksionalitetit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër. Publikimin e këtij opinionit në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e publikimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

\* \* \*

(Pika e 4 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2020

**PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 24.09.2020)*

**Pika 5 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimit “Për përjashtimin e gjyqtarës {...} nga lista e gjyqtarëve që caktohen për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relatore znj. Marçela Shehu).

*Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.*

*Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:08 dhe mbaroi në orën 13:20.*

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. *Naureda Llagami* (kryetare)
2. *Maksim Qoku* (zëvendëskryetar)
3. *Medi Bici* (anëtar)
4. *Fatmira Luli* (anëtare)
5. *Brunilda Kadi* (anëtare)
6. *Dritan Hallunaj* (anëtar)
7. *Ilir Toska* (anëtar)
8. *Alban Toro* (anëtar)
9. *Brikena Ukperaj* (anëtar)

- 10. Marçela Shehu* (anëtare)  
*11. Erjon Muharremaj* (anëtar)

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 2. Helena Papa, Drejtore pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 3. Pjerin Prendi, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 4. Aeksandër Çavo, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 5. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
- 6. Pjesë nga stafi administrativ i Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 7. Entela Dobi, përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
- 8. Përfaqësues të Misionit EURALIUS dhe Projektit të “USAID”.*

#### **RENDI I DITËS:**

5. Shqyrtimi i projektvendimit “Për përjashtimin e gjyqtarës {...} nga lista e gjyqtarëve që caktohen për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relatore znj. Marçela Shehu).

*Naureda Llagami:* Kalojmë në projekt-aktin e radhës i cili ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për përjashtimin e gjyqtarës {...} nga lista e gjyqtarëve që caktohen për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës. Ky projekt-akt do të raportohet nga zonja Marçela Shehu.

*Marçela Shehu:* Faleminderit, Kryetare!

Pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, me datë 03.09.2020, është depozituar kërkesa e gjyqtarës {...}, në detyrë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës, me lëndë: “Kërkesë për t’u përjashtuar nga gjykimi i çështjeve gjyqësore të veçanta në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtrohet funksioni në mënyrë të përhershme”.

Nëpërmjet kësaj kërkesë gjyqtarja kërkon të përjashtohet nga caktimi në gjykata të tjera për të gjykuar çështje gjyqësore të veçanta, për arsye shëndetësore të saj.

Gjyqtarja shprehet se për shkak të problemeve të shtatzënisë, nga ana e mjekut specialist i është rekomanduar regjim shtrati dhe lëvizja në largësi do të ndikonte negativisht në gjendjen e saj shëndetësore.

Gjyqtarja i ka bashkëlidhur kërkesës: Rekomandim nga mjeku Obstetër – Gjinekolog lëshuar me datë 02.09.2020 ku rezulton se pacientja {...} duhet të jetë në regjim shtrati; Ekografi lëshuar më datë 01.06.2020 nga Klinika “Petal”, Tiranë ku konfirmohet edhe gjendja e gravidancës së gjyqtares.

Rregullat për caktimin e gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme, janë miratuar me Vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 30, datë 14.02.2019.

Në këto rregulla, parashikohet ndër të tjera se: “Me kërkesë të motivuar të gjyqtarit dhe të shoqëruar me aktet e nevojshme provuese, Këshilli i Lartë Gjyqësor, për arsye shëndetësore, mund të vendosë përjashtimin gjer në gjashtë muaj të një gjyqtari nga lista e gjyqtarëve që caktohen për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta”.

Sa më sipër, duke mbajtur në konsideratë se gjyqtarja {...} ka paraqitur kërkesë të motivuar dhe të shoqëruar me aktet e nevojshme që vërtetojnë gjendjen e saj shëndetësore, konform pikës 6, paragrafit VIII, të Vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 30, datë 14.02.2019, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës propozon përjashtimin për një afat 6 muaj të gjyqtares nga lista e gjyqtarëve që caktohen për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme.

Me këtë qëllim është përgatitur edhe projektvendimi përkatës me të njëjtën përmbajtje. Faleminderit!

**Naureda Llagami:** Faleminderit, zonja Shehu!

Kemi ndonjë diskutim lidhur me këtë projekt-akt?

Nëse jo, kalojmë në votimin e tij?

*Maksim Qoku*: Dakord.

*Brunilda Kadi*: Dakord.

*Dritan Hallunaj*: Pro.

*Illir Toska*: Dakord.

*Alban Toro*: Dakord.

*Fatmira Luli*: Dakord.

*Marçela Shehu*: Dakord.

*Erjon Muharremaj*: Pro.

*Brikena Ukperaj*: Pro.

*Medi Bici*: Pro.

*Naureda Llagami*: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi: Përfundimin e gjyqtarës znj. {...}, e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës, nga lista e gjyqtarëve që caktohen për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta, për një afat 6-mujor.

Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

\* \* \*

(Pika e 5 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2020

**PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 24.09.2020)*

**Pika 6 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimit “Për mbarimin e statusit të magjistratit për gjyqtaren e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, znj. {...}”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Alban Toro).

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:08 dhe mbaroi në orën 13:20.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Maksim Qoku*** (zëvendëskryetar)
3. ***Medi Bici*** (anëtar)
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Brunilda Kadi*** (anëtare)
6. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
7. ***Illir Toska*** (anëtar)
8. ***Alban Toro*** (anëtar)
9. ***Brikena Ukperaj*** (anëtar)
10. ***Marçela Shehu*** (anëtare)
11. ***Erjon Muharremaj*** (anëtar)

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
2. *Helena Papa, Drejtoreshë pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
3. *Pjerin Prendi, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
4. *Aleksandër Çavo, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
5. *Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
6. *Pjesë nga stafi administrativ i Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
7. *Entela Dobi, përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
8. *Përfaqësues të Misionit EURALIUS dhe Projektit të "USAID".*

#### **RENDI I DITËS:**

6. Shqyrtimi i projektvendimit “Për mbarimin e statusit të magjistratit për gjyqtaren e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, znj. {...}”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Alban Toro).

Kalojmë në projekt-aktin e radhës, i cili ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për mbarimin e statusit të magjistratit për gjyqtaren e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, znj. {...}”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, me relator z. Alban Toro.

*Alban Toro:* Gjyqtarja zonja {...} është gjyqtare e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë e dekretuar si e tillë me Dekret të Presidentit nr.3984, në datën 21.10.2003. Ajo i është drejtuar Këshillit të Lartë Gjyqësor, ndër të tjera që: “Kërkesa ime të merret në konsideratë sa më shpejt të jetë e mundur, pasi të tre fëmijët e mi të mitur më datë 17.09.2020 fillojnë shkollën në Tiranë, djali i madh A. {...} në shkollën e mesme “Ismail Qemali dhe dy fëmijët e tjerë E. {...} dhe A. {...} në shkollën 9-Vjeçare “Fan Noli”, dhe më duhet të jem pranë tyre, pasi nuk ka kush të kujdeset për ta. Në këtë situatë e kam të pamundur të vazhdoj të ushtroj funksionin e gjyqtares pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë.”

Më tej ajo ka kërkuar edhe një saktësim: “Në kushtet kur unë kam vendosur të heqë dorë nga statusi i magjistratit për arsye familjare dhe konkretisht për faktin se më duhet të kujdesem për tre fëmijët e mi të mitur, të cilët sapo kanë filluar shkollën në Tiranë, kërkojë që kërkesa ime për heqjen dorë të miratohet me procedurë të përshpejtuar, bazuar pikës 3 të nenit 65 të ligjit nr. 96/2016”.

Si provë për këtë kërkesë, ajo ka paraqitur vërtetimin 664 prot., datë 15.09.2020 nga Gjinnazi “Ismail Qemali”, Tiranë dhe vërtetimet nr. 190 prot., dhe nr. 191 prot., datë 15.09.2020 nga shkolla e arsimit 9-Vjeçar “Fan S. Noli”, Tiranë.

Gjithashtu është administruar për të parë moscenimi i interesit publik, ku nga ana jonë janë administruar edhe të dhëna të tjera në lidhje me ngarkesën e kësaj gjykate, e cila rezulton se kjo gjykatë ka 757 çështje nga të cilat: Sokol Pina - 143; {...} - 240; {...} - 205; {...} - 162; Nevrie Duka – 0.

Aktualisht, siç e theksuam, kjo gjyqtare ka 240 dosje, nga të cilat 44 janë në shprehur me vendim po nuk ka përfunduar arsyetimi i tyre.

Neni 65 të Ligjit nr. 96/2016 përcakton se: “1. Magjistrati mund të kërkojë mbarimin e statusit, nëpërmjet paraqitjes së dorëheqjes para Këshillit përkatës. 2. Dorëheqja duhet të jetë me shkrim dhe nuk është e nevojshme të jetë e arsyetuar. Dorëheqja jep efektet në fund të muajit pasardhës, nga dita kur Këshilli merr deklarinimin me shkrim të dorëheqjes. Mbarimi i statusit të magjistratit deklarohet me vendim të Këshillit jo më vonë se dy javë nga mbarimi i statusit. 3. Në raste të justifikuara, me kërkesë të motivuar dhe me miratim të Këshillit, dorëheqja mund të japë efekte përpara kohës së përcaktuar në pikën 2 të këtij neni”.

Kështu që, në kushtet kur vullneti i kësaj magjistrateje është qartësuar dhe është siguruar që është i lirshëm dhe i shprehur përpara institucionit në mënyrë të shkruar, gjithashtu është i motivuar, pra gjyqtarja ka parashtruar një motiv të rëndësishëm dhe të justifikuar për dorëheqjen e saj, motiv ky që përveçse personal, nuk mund të vlerësohet si i pajustificuar. Dhënia efekte të dorëheqjes përpara kohës së përcaktuar nga ligji, nuk cenon interesin publik në kuptimin e krijimit të ndonjë shtate negative të pakthyeshme për dhënien e drejtësisë, e cila në çdo rast është në vëmendjen e Këshillit në këto raste kur miratohet një dorëheqje e tillë.

Për këtë qëllim, nga ana jonë ju propozohet për të vlerësuar të drejtë kërkesën e kryer nga ana e kësaj gjyqtareje, dhe si shkak për përfundimin e statusit të magjistratit propozohet të japë efekte në datë 30.09.2020.

Në këtë kuadër është përgatitur drafti përkatës, në dispozitivin e të cilit do të gjeni dhe ju sugjerohet të miratoni: Deklarimin e mbarimit të statusit të magjistratit për znj. {...}, gjyqtare e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, për shkak të dorëheqjes së saj nga ky status. Efektet e këtij urdhërimi fillojnë më datë 30.09.2020. Të përjashtojë gjyqtaren znj. {...} nga procedurat e ndarjes me short të çështjeve gjyqësore në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Sarandë. Një kopje e këtij vendimi i njoftohet gjyqtares znj. {...} sipas kërkesave të shkronjës “b”, të pikës 1, të nenit 98, të Ligjit nr. 115/2016. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit, në Gjykatën Administrative të Apelit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Faleminderit!

**Naureda Llagami:** Faleminderit, zoti Toro!

Kemi ndonjë diskutim nga kolegët?

Nëse jo, kalojmë në votimin e projekt-aktit?

**Maksim Qoku:** Dakord.

**Brunilda Kadi:** Dakord.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Ilir Toska:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Dakord.

**Marçela Shehu:** Dakord.

**Erjon Muharremaj:** Pro.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Medi Bici:** Pro.

**Naureda Llagami:** Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi: 1. Deklarimin e mbarimit të statusit të magjistratit për znj. {...}, gjyqtare e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, për shkak të dorëheqjes së saj nga ky status.

2. Efektet e këtij urdhërimi fillojnë më datë 30.09.2020.

3. Të përjashtojë gjyqtaren znj. {...} nga procedurat e ndarjes me short të çështjeve gjyqësore në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Sarandë.

4. Një kopje e këtij vendimi i njoftohet gjyqtares znj. {...} sipas kërkesave të shkronjës “b”, të pikës 1, të nenit 98, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, si dhe bëhet publik në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit, në Gjykatën Administrative të Apelit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

\* \* \*

(Pika e 6 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2020

**PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 24.09.2020)*

**Pika 7 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimit “Për verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...} të tre kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, për pozicione të lira në fushën e të drejtës penale, të shpallura me vendimet nr. 242 dhe nr. 244, datë 09.07.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Alban Toro).

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:08 dhe mbaroi në orën 13:20.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Maksim Qoku*** (zëvendëskryetar)
3. ***Medi Bici*** (anëtar)
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Brunilda Kadi*** (anëtare)
6. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
7. ***Illir Toska*** (anëtar)
8. ***Alban Toro*** (anëtar)

9. *Brikena Ukperaj* (anëtar)  
10. *Marçela Shehu* (anëtare)  
11. *Erjon Muharremaj* (anëtar)

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
2. *Helena Papa, Drejtore pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
3. *Pjerin Prendi, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
4. *Aleksandër Çavo, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
5. *Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
6. *Pjesë nga stafi administrativ i Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
7. *Entela Dobi, përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
8. *Përfaqësues të Misionit EURALIUS dhe Projektit të "USAID".*

#### **RENDI I DITËS:**

7. Shqyrtimi i projektvendimit "Për verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...} të tre kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, për pozicione të lira në fushën e të drejtës penale, të shpallura me vendimet nr. 242 dhe nr. 244, datë 09.07.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit", i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Alban Toro).

*Naureda Llagami:* Kalojmë në projekt-aktin e radhës i cili ka të bëjë me verifikimin e plotësimit të kritereve ligjore nga kandidatja znj. {...}, për pozicione të lira në fushën e të drejtës penale në Gjykatën e Lartë. Për më shumë detaje, fjalën ia jap sërish zotit Alban Toro.

*Alban Toro:* Faleminderit!

Me vendimin nr. 242 dhe nr. 244, 09.07.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor është proceduar me hapjen e procedurave të ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, nga radhët e

gjqtarëve, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës penale, pra kemi dy pozicione të lira në fushën e të drejtës penale dhe një nga kandidatët për këtë pozicion të lirë ka qenë edhe znj. {...}. Më lejoni t'ju kujtoj se e njëjta kandidate ka kandiduar edhe më herët me vendimin 85 dhe 86, datë 26.02.2020 ku ka pasur dy pozicione të lira në fushën e së drejtës civile dhe kandidatja ka kandiduar edhe për këto. Madje me vendimin nr.212, 18.06.2020, Këshilli vendosi që verifikimi i plotësimit të kriterëve nga kandidatja {...} në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë për dy pozicione të lira në fushën e së drejtës civile, të shpallura me vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 85 dhe nr. 86, datë 26.02.2020, të kriterit të “përvojës profesionale minimale”, të “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe të “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”. Vijimin e procedurës së verifikimit të kandidates për kriteret e tjera ligjore të kandidimit në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, për dy pozicione të lira në fushën e të drejtës civile, të shpallura me Vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 85 dhe nr.86, datë 26.02.2020. Pas këtij vendimi, kandidatja është në procedurë vlerësimi profesional nga komisioni përkatës dhe gjithashtu kësaj kandidateje i është bërë e ditur dhe qëndrimi unifikues që ka mbajtur Këshilli në lidhje me kandidimet, pra ata nuk duhet të kalojnë më shumë sesa 3 pozicione kandidimi dhe në këtë kuadër, kandidatja znj. Boksi, në përgjigje të kërkesës, ka shprehur vullnetin për të vijuar kandidimin për pozicionin e lirë në fushën e së drejtës civile të shpallur me vendimin nr. 85 si dhe për dy pozicionet e lira në fushën e së drejtës penale, të shpallura me vendimet nr. 242 dhe nr. 244, datë 09.07.2020.

Më herët relatori ka hartuar relacionin për tërheqjen e zonjës {...} nga kandidimi në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë për pozicionin e lirë në fushën e së drejtës civile, të shpallur me Vendimin nr. 86, datë 26.02.2020. Në këtë vendim, ndër të tjera përcaktohet përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me Vendimin nr. 86, datë 26.02.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për kandidaten znj. {...}, për shkak të tërheqjes së saj nga kandidimi për këtë pozicion.

Sa i përket verifikimit të plotësimit nga kandidatja znj. {...} të tre kriterëve formale të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, për pozicionet e lira në



fushën e të drejtës penale, të shpallura me Vendimet e Këshillit, nr. 242 dhe nr. 244, datë 09.07.2020, pra të kriterëve të “përvojës profesionale minimale”, “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”, në kushtet kur kandidatja është verifikuar për plotësimin e këtyre kriterëve në kuadër të kandidimeve të saj për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë për dy pozicionet e tjera të lira në fushën e së drejtës civile, u çmua se nuk kishte vend për kërkimin dhe administrimin përsëri të njëjtit dokumentacion zyrtar, duke qenë i vlefshëm për qëllimet e këtij verifikimi, dokumentacioni i administruar më parë. Referuar gjykatave ku kandidatja ka ushtruar funksionin e gjyqtares, u vlerësua jo i nevojshëm rikërkimi i informacionit, pasi referuar përmbajtjes së tyre konkludohen të dhëna edhe për përvojën specifike profesionale të kandidates në fushën e të drejtës penale, ndërsa është e qartë përvoja e kandidates në këtë fushë të së drejtës pranë Gjykatës së Apelit për Krimet e Rënda dhe Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

Me cilësinë e relatorit, pasi kam analizuar ato informacione që në këto kandidime, rezulton se kjo gjyqtare ka mbi 19 vjet përvojë të përgjithshme profesionale si gjyqtare në shkallën e parë dhe shkallën e dytë dhe si e komanduar, duke plotësuar kështu kriterin e “përvojës profesionale minimale”. Gjithashtu, nga të dhënat dhe nga dokumentacioni i administruar gjatë verifikimit, kandidatja {...}, deri në momentin e kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë për pozicionin e lirë të shpallura me Vendimet e Këshillit nr. 242 dhe nr. 244, datë 09.07.2020, rezulton të ketë mbi pesë vjet përvojë profesionale në fushën e të drejtës penale. Nuk vërtetohet që kandidatja znj. {...} të ketë masë disiplinore në fuqi dhe nga dokumentacioni i administruar gjatë verifikimeve për kandidaten znj. {...} nuk vërtetohet të ndodhet në situatën e papajtueshmërisë ambientale në rast të ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë.

Relatori, pasi ia ka kaluar Komisionit për miratim, ky i fundit ia parashtron në mbledhjen e datës 18.09.2020 dhe e ka kaluar për shqyrtim Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Në kuadër të përfundimit të kësaj praktike është përgatitur projekti përkatës, në dispozitivin e të cilës ju sugjerohet të miratoni si vijoni:

1. Verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...} në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, për pozicione të lira në fushën e të drejtës penale, të shpallura

me Vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr.242 dhe nr.244, datë 09.07.2020, të kritereve të “përvojës profesionale minimale”, të “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe të “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”.

2. Vijimin e procedurës së verifikimit të kandidatës për kriteret e tjera ligjore të kandidimit në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, për pozicione të lira në fushën e të drejtës penale, të shpallura me Vendimet e Këshillit të Lartë nr.242 dhe nr.244, datë 09.07.2020.

3. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidatës znj. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e publikimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Faleminderit!

**Naureda Llagami:** Faleminderit, zoti Toro!

Nëse nuk keni ndonjë diskutim mbi projekt-aktin, kalojmë në votimin e tij?

**Maksim Qoku:** Dakord.

**Brunilda Kadi:** Dakord.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Ilir Toska:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Dakord.

**Marçela Shehu:** Dakord.

**Erjon Muharremaj:** Pro.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Medi Bici:** Pro.

**Naureda Llagami:** Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi: 1. Verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...} të tre kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, për pozicione të lira në fushën e të drejtës penale, të shpallura me vendimet nr. 242 dhe nr. 244, datë 09.07.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për

kriteret e tjera ligjore të kandidimit, sipas propozimit të ardhur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

\* \* \*

(Pika e 7 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2020

**PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 24.09.2020)*

**Pika 8 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimit “Për verifikimin e plotësimit nga kandidati z. {...} të tre kriterëve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, për pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr.87 datë 26.02.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relatore znj. Marçela Shehu).

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:08 dhe mbaroi në orën 13:20.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Maksim Qoku*** (zëvendëskryetar)
3. ***Medi Bici*** (anëtar)
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Brunilda Kadi*** (anëtare)
6. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
7. ***Illir Toska*** (anëtar)
8. ***Brikena Ukperaj*** (anëtar)

9. *Marçela Shehu* (anëtare)  
10. *Erjon Muharremaj* (anëtar)

**Shënim:** Nuk merr pjesë në shqyrtimin e kësaj çështjeje anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. *Alban Toro*.

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
2. *Helena Papa, Drejtore pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
3. *Pjerin Prendi, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
4. *Aleksandër Çavo, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
5. *Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
6. *Pjesë nga stafi administrativ i Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
7. *Entela Dobi, përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
8. *Përfaqësues të Misionit EURALIUS dhe Projektit të "USAID".*

#### **RENDI I DITËS:**

8. Shqyrtimi i projektvendimit "Për verifikimin e plotësimit nga kandidati z. {...} të tre kriterëve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, për pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr.87 datë 26.02.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit", i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relatore znj. Marçela Shehu).

*Naureda Llagami:* Kalojmë në projekt-aktin e radhës i cili ka të bëjë me verifikimin e plotësimit të kriterëve ligjore për kandidatin z. {...}.

Për më shumë detaje, fjalën ia jap sërish relatores Marçela Shehu.

*Marçela Shehu:* Faleminderit, Kryetare!

Përpara se të filloj, do kujtoja që anëtari i Këshillit, zoti Toro, nuk duhet të marrë pjesë në shqyrtimin e këtij projektvendimi për shkak të papajtueshmërisë së tij, që është konstatuar edhe më parë.

*Alban Toro:* Po, -faleminderit! Po dal edhe një herë.

*Marçela Shehu:* Kandidati, gjyqtari {...} ka kandiduar për një pozicion të lirë në fushën e së drejtës civile në Gjykatën e Lartë, konkretisht për pozicionin e shpallur me vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor, nr. 87, datë 26.02.2020. Në fakt, ky gjyqtar ka kandiduar edhe për pozicionin në fushën e së drejtës civile, të shpallur me vendimin e Këshillit nr. 86, por duke qenë se aplikimi i tij për pozicionin nr. 87 është protokolluar pas vendimit të Këshillit për verifikimin e kriterëve formale që lidhen me pozicionin nr. 86, Komisioni ka vlerësuar që edhe për kandidimin e tij për pozicionin nr. 87, duhej përgatitur projektvendimi përkatës për verifikimin e plotësimit nga ky kandidat të kriterëve formale që lidhen me kandidimin e tij për pozicionin nr. 87 të shpallur nga Këshilli, në fushën e së drejtës civile.

Lidhur me kriteret për sa i përket verifikimit të plotësimit nga kandidati të kriterëve të “përvojës profesionale minimale”, të “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”, në kushtet kur kandidati është verifikuar për plotësimin e këtyre kriterëve, në kuadër të kandidimit të tij (siç e citova) për pozicionin e lirë në fushën e së drejtës civile për pozicionin nr. 86, u çmua se nuk kishte vend për kërkimin dhe administrimin përsëri të të njëjtit dokumentacion zyrtar, duke qenë i vlefshëm për qëllimet e këtij verifikimi dokumentacioni i administruar më parë, pra dokumentacioni që vërtetonte përvojën e tij si të përgjithshme, edhe specifike për pozicionin e shpallur.

Gjithsesi për kriteret e “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe “mosqenies në situatë të papajtueshmërisë ambientale”, u kryen disa veprime verifikuese në funksion të verifikimit të ekzistencës të ndonjë të dhëne të ndryshme nga sa më parë, kjo për shkak se këto rrethana janë potencialisht të ndryshueshme, qoftë edhe në një kohë të shkurtër.

Pas procesit tërësor të verifikimit të tre kritereve edhe për këtë pozicion (për pozicionin nr. 87), pas procesit të verifikimit, ka rezultuar që kandidati {...} i plotëson të gjitha këto kritere. Rezulton të ketë përvojë të përgjithshme profesionale mbi 13 vjet si gjyqtar në shkallë më të ulët. Rezulton të ketë mbi 5 vjet përvojë profesionale specifike në fushën e së drejtës civile. Nuk rezulton të ketë masa disiplinore në fuqi dhe nuk paraqiten situata që vënë në dyshim ekzistencën e papajtueshmërisë ambientale në rast të ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë.

Në këto kushte, pasi është paraqitur edhe në Komision nga ana ime si relatorë, duke propozuar kalimin në mbledhje plenare dhe pasi Komisioni ka vlerësuar të plotë procedurën e verifikimit, me cilësinë e relatores i propozoj Këshillit verifikimin e plotësimit nga kandidati lidhur me pozicionin nr. 87, të tre kritereve të “përvojës profesionale minimale”, të “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe të “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”. Faleminderit!

***Naureda Llagami:*** Faleminderit!

Kemi ndonjë diskutim lidhur me projekt-aktin e propozuar?

Nëse jo, kalojmë në votim sipas propozimit të bërë nga Komisioni?

***Maksim Qoku:*** Dakord.

***Brunilda Kadi:*** Dakord.

***Dritan Hallunaj:*** Pro.

***Ilir Toska:*** Dakord.

***Fatmira Luli:*** Dakord.

***Marçela Shehu:*** Dakord.

***Erjon Muharremaj:*** Pro.

***Brikena Ukperaj:*** Pro.

***Medi Bici:*** Pro.

***Naureda Llagami:*** Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi miratimin e projektvendimit “Për verifikimin e plotësimit nga kandidati z. {...} të tre kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me

vendimin nr.87 datë 26.02.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit”, sipas propozimit të ardhur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

\* \* \*

(Pika e 8 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2020

**PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 24.09.2020)*

**Pika 9 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimit “Për verifikimin e plotësimit nga kandidati z. {...} të tre kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, për pozicionet e lira në fushën e të drejtës penale, të shpallura me vendimet nr. 241, nr. 242 dhe nr. 244, datë 09.07.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relatore znj. Marçela Shehu).

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:08 dhe mbaroi në orën 13:20.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Maksim Qoku*** (zëvendëskryetar)
3. ***Medi Bici*** (anëtar)
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Brunilda Kadi*** (anëtare)
6. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
7. ***Illir Toska*** (anëtar)
8. ***Alban Toro*** (anëtar)

9. *Brikena Ukperaj* (anëtar)  
10. *Marçela Shehu* (anëtare)  
11. *Erjon Muharremaj* (anëtar)

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
2. *Helena Papa, Drejtore pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
3. *Pjerin Prendi, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
4. *Aleksandër Çavo, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
5. *Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
6. *Pjesë nga stafi administrativ i Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
7. *Entela Dobi, përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
8. *Përfaqësues të Misionit EURALIUS dhe Projektit të "USAID".*

#### **RENDI I DITËS:**

9. Shqyrtimi i projektvendimit "Për verifikimin e plotësimit nga kandidati z. {...} të tre kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, për pozicionet e lira në fushën e të drejtës penale, të shpallura me vendimet nr. 241, nr. 242 dhe nr. 244, datë 09.07.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit", i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relatore znj. Marçela Shehu).

*Naureda Llagami:* Kalojmë në projekt-aktin tjetër.

Ndoshta duhet të njoftojmë zotin Toro të jetë "online".

*(Zoti Toro futet në platformë dhe është prezent.)*

Atëherë, duke qenë se zoti Toro është "online", kalojmë në projekt-aktin e radhës i cili ka të bëjë me verifikimin e plotësimit për kandidatin z. {...} të tre kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë. Për më shumë detaje ia jap fjalën sërish zonjës Marçela Shehu.

**Marçela Shehu:** Kandidati, gjyqtari {...} ka kandiduar në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë për pozicionet e lira në fushën e së drejtës penale, të shpallura me vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 241, nr. 242 dhe nr. 244, datë 09.07.2020. Është realizuar procesi i verifikimit lidhur me plotësimin ose jo të kandidatit të kritereve të “përvojës profesionale minimale”, të “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe të “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”. Pas procesit të verifikimit ka rezultuar se kandidati i plotëson të tre këto kritere. Ai rezulton të ketë mbi 13 vjet përvojë të përgjithshme profesionale si gjyqtar i shkallës së parë. Rezulton të ketë mbi 5 vjet përvojë profesionale specifike në fushën e të drejtës penale. Nuk rezulton të ketë masa disiplinore në fuqi dhe nuk ndodhet në situatën e papajtueshmërisë ambientale.

Në këto kushte, me cilësinë e relatores, i propozoj Këshillit të Lartë Gjyqësor verifikimin e plotësimit nga kandidati të këtyre kritereve dhe vijimin e procedurës së verifikimit të kandidatit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit në procedurën e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë. Faleminderit! Ky ishte projektvendimi i propozuar.

**Naureda Llagami:** Faleminderit, zonja Shehu!

Nëse nuk keni ndonjë diskutim mbi projekt-aktin, kalojmë në votimin e tij?

**Maksim Qoku:** Dakord.

**Brunilda Kadi:** Dakord.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Ilir Toska:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Dakord.

**Marçela Shehu:** Dakord.

**Erjon Muharremaj:** Pro.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Medi Bici:** Pro.

**Naureda Llagami:** Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi miratimin e vendimit “Për verifikimin e plotësimit nga kandidati z. {...} të tre kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë,

për pozicionet e lira në fushën e të drejtës penale, të shpallura me vendimet nr. 241, nr. 242 dhe nr. 244, datë 09.07.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit”, sipas propozimit të ardhur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

\* \* \*

(Pika e 9 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2020

**PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 24.09.2020)*

**Pika 10 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimit “Për caktimin e relatorit në procedurat e verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Lartë, për kandidatët znj. {...} dhe znj. {...}”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Ilir Toska).

*Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.*

*Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:08 dhe mbaroi në orën 13:20.*

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. *Naureda Llagami* (kryetare)
2. *Maksim Qoku* (zëvendëskryetar)
3. *Medi Bici* (anëtar)
4. *Fatmira Luli* (anëtare)
5. *Brunilda Kadi* (anëtare)
6. *Dritan Hallunaj* (anëtar)
7. *Ilir Toska* (anëtar)
8. *Brikena Ukperaj* (anëtar)
9. *Marçela Shehu* (anëtare)
10. *Erjon Muharremaj* (anëtar)

**Shënim:** Nuk merr pjesë në shqyrtimin e kësaj çështjeje anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. *Alban Toro*.

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
2. *Helena Papa, Drejtore pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
3. *Pjerin Prendi, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
4. *Aeksandër Çavo, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
5. *Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
6. *Pjesë nga stafi administrativ i Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
7. *Entela Dobi, përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
8. *Përfaqësues të Misionit EURALIUS dhe Projektit të “USAID”.*

#### **RENDI I DITËS:**

10. Shqyrtimi i projektvendimit “Për caktimin e relatorit në procedurat e verifikimit të kritereve ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Lartë, për kandidatët znj. {...} dhe znj. {...}”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Ilir Toska).

*Naureda Llagami:* Kalojmë në dy projekt-aktet e fundit që janë përkatësisht për hedhjen e shortit.

*Alban Toro:* Ndjesë! Një ndërprerje të vogël.

*Naureda Llagami:* Po, Alban!

*Alban Toro:* Para se të më nxjerrë Marçela jashtë, po dal vet sepse është pika 10 që ka të bëjë me kandidatë për të cilët unë kam dhënë dorëheqjen, por edhe shtesa e rendit të ditës ka të njëjtin karakter. Kështu që për të dyja pikat unë po dalë jashtë. Faleminderit!

*Naureda Llagami:* Atëherë, vijojmë me projekt-aktin e parë “Për caktimin e relatorit në procedurat e verifikimit të kritereve ligjore të kandidimit për gjyqtar në

Gjykatën e Lartë, për kandidatët znj. {...} dhe znj. {...}”, përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës dhe do relatohet nga zoti Toska.

***Ilir Toska: Faleminderit!***

Komisioni i Zhvillimit të Karrierës ka përgatitur projektvendimin “Për caktimin e relatorit në procedurat e verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Lartë, për kandidatët znj. {...} dhe znj. {...}”. Ky projektvendim është përgatitur në kushtet kur me vendimet nr. 84, datë 26.02.2020 dhe nr. 245, datë 09.07.2020, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka hapur procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë për dy pozicione të lira në fushën e të drejtës administrative, ndërsa me vendimin nr.87, datë 26.02.2020, Këshilli ka hapur procedurën e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile.

Në këto procedura ngritjeje në detyrë në Gjykatën e Lartë, brenda afateve të kandidimit, kanë kandiduar edhe gjyqtaret znj. {...} dhe znj. {...}. Po ashtu, në këto procedura ngritjeje në detyrë ka kandiduar edhe gjyqtarja {...}.

Me vendimin nr.151, datë 06.05.2020, ndër të tjera, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka vendosur: I. Fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Lartë, për kandidatët nga radhët e gjyqtarëve që kanë aplikuar për pozicionet e lira të shpallura me Vendimin nr. 82, datë 26.02.2020 (në fushën e të drejtës administrative) dhe me Vendimin nr. 85, datë 26.02.2020 (në fushën e të drejtës civile), të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe ka caktuar relator për secilin kandidat, ku për kandidaten znj. {...} dhe znj. {...} (pikë 2 dhe 9) është caktuar si relator z. Alban Toro.

Me tej, me vendimin nr. 201, datë 11.06.2020, Këshilli i Lartë Gjyqësor, ndër të tjera, ka vendosur: Fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Lartë, për kandidatët nga radhët e gjyqtarëve që kanë aplikuar për pozicionet e lira, ndër të tjera edhe për atë me nr. 86, datë 26.02.2020 (në fushën e të drejtës civile), ndërkohë që në pikën 3 të këtij vendimi është vendosur që “...Për kandidatët (ndër të tjera) znj. {...}, ..., znj. {...}, ..., të cilët kanë aplikuar për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë edhe për pozicionet e lira të shpallura me Vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 82 dhe nr. 85, datë 26.02.2020, procedurat e verifikimit që janë në

proces e sipër për këto kandidime, janë të vlefshme edhe për kandidimin e tyre, sipas rastit, për një ose të dyja pozicionet e lira të shpallura nga Këshilli i Lartë Gjyqësor me Vendimet nr. 83 dhe nr. 84, datë 26.02.2020”.

Në vijim, me Vendimin nr. 268, datë 07.08.2020, Këshilli i Lartë Gjyqësor, ndër të tjera, ka vendosur: Fillimin e procedurës së verifikimit të kritereve ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Lartë, për kandidatët nga radhët e gjyqtarëve që kanë aplikuar për pozicionet e lira të shpallura, ndër të tjera edhe me vendimet nr.87, datë 26.02.2020 (në fushat e të drejtës civile), ndërkohë që në pikën 5 të këtij projektvendimi është vendosur që “Për kandidatët ... znj. {...}, ..., të cilët kanë kandiduar më parë për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë ..., procedurat e verifikimit sa i përket pasurisë dhe figurës që janë në proces e sipër për këto kandidime, janë të vlefshme edhe për kandidimet e tyre për një ose disa nga pozicionet e lira në Gjykatën e Lartë, të shpallura me Vendimet .. nr. 87, datë 26.02.2020”.

Ndërsa në procedurën e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, për dy pozicionet e lira në fushën e të drejtës administrative, të shpallura me vendimet e Këshillit nr. 84, datë 26.02.2020 dhe nr. 245, datë 09.07.2020, si dhe për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin e Këshillit nr. 87, datë 26.02.2020, ka kandiduar edhe gjyqtarja znj. {...}, që është bashkëshortja e anëtarit të Këshillit z. Alban Toro, ky i fundit, nëpërmjet një kërkesë me shkrim, protokolluar pranë Këshillit më datë 06.08.2020, ka hequr dorë nga pjesëmarrja në këto procedura ngritjeje në detyrë në Gjykatën e Lartë. Dorëheqja e z.Toro është miratuar me vendimin e Kryetares së Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 3, datë 06.08.2020.

Krahas kësaj, nëpërmjet kërkesës së tij, anëtarit i Këshillit z. Alban Toro ka hequr dorë edhe nga pjesëmarrja në procedurat e ngritjes në detyrë për ata kandidatë konkurrimi i të cilëve, sipas tij, interferon me konkurrimin e bashkëshortes së tij, ku nëpërmjet kërkesës së protokolluar pranë Këshillit më datë 09.09.2020, me objekt “Dorëzimin e akteve të procedurës së verifikimit”, ka identifikuar si të tillë kandidatet znj. {...} dhe znj. {...}, për procedurat e verifikimit për të cilat ai, me vendimet e sipër përmendura të Këshillit, është caktuar si relator. Edhe kjo kërkesë e z.Toro është miratuar me vendimin e Kryetares së Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 10, datë 11.09.2020.



Ndërkohë, si anëtar zëvendësues i z.Toro në Komisionin e Zhvillimit të Karrierës, sipas vendimit të Këshillit nr. 13, datë 18.01.2019, është caktuar znj. Naureda Llagami, por ajo nuk mund të jetë relatore në procedura në të cilat Komisioni ose Këshilli duhet të miratojnë akte administrative individuale në lidhje me statusin profesional të gjyqtarëve të veçantë, referuar për këtë përcaktimit të bërë në pikën 1, të nenit 63, të Ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Në këto kushte bëhet e nevojshme caktimi i relatorit për procedurat e verifikimit të kandidateve për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, znj. {...} dhe znj. {...}. Bazuar në Kreun V, Seksioni A, pika 2, të Vendimit të Këshillit nr. 75, datë 23.05.2019, “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë”, caktimi i relatorit duhet të bëhet nëpërmjet shortit, ndërmjet dy anëtarëve të tjerë të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës.

Sa më lart, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës ka përgatitur projektvendimin “Për caktimin e relatorit në procedurat e verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Lartë, për kandidatet znj. {...} dhe znj. {...}”.

Projektvendimi përbëhet vetëm nga një pike e cila bën fjalë pikërisht për caktimin e relatorit në procedurat e verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Lartë, për kandidatet znj. {...} dhe znj. {...}, bazuar kjo në rezultatet e shortit të hedhur për këtë qëllim ndërmjet dy anëtarëve të përhershëm të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, pra mes meje dhe znj. Marçela Shehu.

Në projektvendim përcaktohet dhe hyrja në fuqi e tij, konkretisht menjëherë me botimin në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

***Naureda Llagami:*** Faleminderit, zoti Toska!

Le të vijojmë me procedurën e shortit.

Hidhen në vazon e qelqit shiritat e letrës me emrat e dy kandidateve, fillimisht znj. {...} dhe më pas znj. {...}.

Hidhen në vazon tjetër të qelqit shiritat e letrës me emrat e dy anëtarëve të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës: z. Ilir Toska dhe znj. Marçela Shehu.

Pas përfundimit të shortit rezulton:

Për kandidaten znj. {...}, relatore znj. Marçela Shehu.

Për kandidaten znj. {...}, relator z. Ilir Toska.

**Naureda Llagami:** Kalojmë në votim?

**Maksim Qoku:** Dakord.

**Brunilda Kadi:** Dakord.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Ilir Toska:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Dakord.

**Marçela Shehu:** Dakord.

**Erjon Muharremaj:** Pro.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Medi Bici:** Pro.

**Naureda Llagami:** Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi: 1. Caktimin e relatorit në procedurat e verifikimit të kritereve ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Lartë, për kandidatet znj. {...} dhe znj. {...}, si më poshtë:

1. Për kandidaten znj. {...}, relatore znj. Marçela Shehu.

2. Për kandidaten znj. {...}, relator z. Ilir Toska.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë me botimin në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

\* \* \*

(Pika e 10 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2020

**PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 24.09.2020)*

**Pika 11 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimit “Për caktimin e relatorit në procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Lartë, për kandidatin z. {...}”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Ilir Toska).

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:08 dhe mbaroi në orën 13:20.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Maksim Qoku*** (zëvendëskryetar)
3. ***Medi Bici*** (anëtar)
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Brunilda Kadi*** (anëtare)
6. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
7. ***Ilir Toska*** (anëtar)
8. ***Brikena Ukperaj*** (anëtar)
9. ***Marçela Shehu*** (anëtare)
10. ***Erjon Muharremaj*** (anëtar)

**Shënim:** Nuk merr pjesë në shqyrtimin e kësaj çështjeje anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. *Alban Toro*.

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
2. *Helena Papa, Drejtore pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
3. *Pjerin Prendi, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
4. *Aleksandër Çavo, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
5. *Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
6. *Pjesë nga stafi administrativ i Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
7. *Entela Dobi, përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
8. *Përfaqësues të Misionit EURALIUS dhe Projektit të “USAID”.*

#### **RENDI I DITËS:**

11. Shqyrtimi i projektvendimit “Për caktimin e relatorit në procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Lartë, për kandidatin z. {...}”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Ilir Toska).

*Naureda Llagami:* Kalojmë tek çështja e fundit të rendit të ditës, që edhe kjo ka të bëjë me caktimin e relatorit në procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Lartë, për kandidatin z. {...}. Për më shumë detaje, fjalën ia jap zotit Toska.

*Ilir Toska:* Faleminderit!

Me vendimin nr. 172, datë 11.09.2019, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka vendosur: “Shpalljen e procedurës së emërimit në Gjykatën e Lartë dhe bërjen e thirrjes për paraqitjen e kandidaturave, nga radhët e juristëve të spikatur, për një pozicion të lirë, që plotësojnë kërkesat specifike për ekspertizë të veçantë në fushën e të drejtës civile”.

Në këtë procedurë emërimi/ngritjeje në detyrë në Gjykatën e Lartë, brenda afatit të kandidimit, ka kandiduar edhe z. {...}.

Me Vendimin nr. 182, datë 02.10.2019, ndër të tjera, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka vendosur: “I. Fillimin e procedurës së verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Lartë, për kandidatët nga radhët e juristëve të spikatur, që kanë aplikuar për pozicionin e lirë të shpallur nga Këshilli i Lartë Gjyqësor me Vendimin nr. 172, datë 11.09.2019.

II. Caktimin e relatorit për secilin kandidat, si më poshtë:

1. Për kandidatin z. {...} - relator z. Alban Toro. ...”.

Procedura e verifikimit si më lart, filluar me Vendimin e Këshillit nr. 182, datë 02.10.2019, për kandidatin z. {...}, nuk ka përfunduar ende.

Më datë 23.09.2020, z. Alban Toro, ka depozituar në Këshill një kërkesë me shkrim, nëpërmjet të cilës ka hequr dorë nga pjesëmarrja në procedurën e verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Lartë, të z. {...}. Dorëheqja e z. Toro është miratuar me Vendimin e Kryetares së Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 12, datë 23.09.2020.

Ndërkohë, si anëtar zëvendësues i z. Toro në Komisionin e Zhvillimit të Karrierës, sipas vendimit të Këshillit nr. 13, datë 18.01.2019, është caktuar znj. Naureda Llagami, por ajo referuar pikës 1, të nenit 63 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar nuk mund të jetë relatore në procedura në të cilat Komisioni ose Këshilli duhet të miratojnë akte administrative individuale në lidhje me statusin profesional të gjyqtarëve të veçantë.

Në këto kushte bëhet e nevojshme caktimi i relatorit për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Lartë, për kandidatin z. {...}. Bazuar në Kreun V, Seksioni A, pika 2, të Vendimit të Këshillit nr. 75, datë 23.05.2019, caktimi i relatorit duhet të bëhet nëpërmjet shortit, ndërmjet dy anëtarëve të tjerë të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës.

Sa më lart, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës ka përgatitur projektvendimin “Për caktimin e relatorit në procedurën e verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Lartë, për kandidatin z. {...}”.

Projektvendimi përbëhet vetëm nga një pikë e cila bën fjalë pikërisht për caktimin e relatorit në procedurën e verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Lartë, për kandidatin z. {...}, bazuar kjo në rezultatet e shortit të hedhur për këtë qëllim ndërmjet dy anëtarëve të përhershëm të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, mes meje dhe znj. Marçela Shehu.

Në projektvendim përcaktohet dhe hyrja në fuqi e tij, konkretisht menjëherë me botimin në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Faleminderit!

**Naureda Llagami:** Faleminderit!

Vijojmë me procedurën e shortit.

Në enën e qelqit futen shiritat e letrës me emrat e dy anëtarëve të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës: z. Ilir Toska dhe znj. Marçela Shehu.

Pas procedurës së shortit rezultoi:

Për kandidatin z. {...}, relator z. Ilir Toska.

**Naureda Llagami:** Ndjesë, se u shkëput interneti.

Atëherë, kalojmë në votimin e projekt-aktit?

**Maksim Qoku:** Dakord.

**Brunilda Kadi:** Dakord.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Ilir Toska:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Dakord.

**Marçela Shehu:** Dakord.

**Erjon Muharremaj:** Pro.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Medi Bici:** Pro.

**Naureda Llagami:** Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi: 1. Caktimin e z. Ilir Toska si relator në procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Lartë, për kandidatin z. {...}.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë me botimin në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Me kaq mbyllim edhe mbledhjen e sotshme.

Ju uroj ditë të mbarë!

\* \* \*

(Pika e 11 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**